



REPUBLIKA E SHqipëRIË
MINISTRIA E FINANCËVE
DHE EKONOMISË

RAPORT VJETOR

FINANCAT PUBLIKE VENDORE

2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E FINANCAVE VENDORE

Raport Vjetor 2019

Financat Publike Vendore

Maj 2020

Të nderuar kryetarë, financiarë, përdorues dhe lexues të tjerë të raportit,

Pas reformës administrativo-territoriale, dhe ndryshimeve të tjera ligjore, Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm në menaxhimin financiar në nivel vendor. Reformat në qeverisjen vendore u shoqëruan me thellimin dhe konsolidimin e decentralizimit të shërbimeve, si dhe me një reformë të rëndësishme të decentralizimit fiskal. Këto reforma kanë ndihmuar që fondet për qeverisjen vendore të rriten ndjeshëm. Miratimi i Ligjit për Financat e Vetëqeverisjes Vendore, si dhe i akteve nënligjore në zbatim të tij kanë bërë që menaxhimi i financave publike në nivel vendor të marrin një dimension të ri zhvillimi. Madhësia e transfertës së pakushtëzuar si një ndër burimet kryesore të financimit të buxhetit të shtetit për qeverisjen vendore, është rritur me 42% në raport me vitin 2015, si vit para fillimit të zbatimit të reformës administrative-territoriale. Por nga ana tjetër janë përmirësuar ndjeshëm kompetencat e bashkive për të vendosur dhe mbledhur taksa e tarifa vendore dhe për të menaxhuar kapacitetin fiskal të burimeve të veta të financimit. Rritja e kapacitetit të pushtetit vendor përmes decentralizimit fiskal, besojmë fort se është një formë e mirë për zhvillimin cilësor të shërbimeve publike në interes të qytetarëve.

Përgjatë viteve të fundit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka drejtuar reforma të rëndësishme të cilat kanë rritur dhe përmirësuar kuadrin rregullator për burimet e financimit të njësive të vetëqeverisjes vendore. Për më tepër, rritja e tyre është shoqëruar me një decentralizim të plotë të mënyrës së përdorimit të tyre nga njësitet e vetëqeverisjes vendore. Kjo nënkupton një rritje të autonomisë fiskale e financiare të vetëqeverisjes vendore, që është një nga elementët kryesorë e të domosdoshëm për forcimin e qeverisjes dhe demokracisë vendore.

Kjo rritje e autonomisë fiskale dhe financiare e vetëqeverisjes vendore duhet të shoqërohet me një rritje të cilësisë së shërbimeve që ofrojnë njësitet e vetëqeverisjes vendore, duke siguruar një përdorim eficient, efektiv dhe ekonomik të burimeve financiare në dispozicion. Për të harmonizuar rritjen e autonomisë me disiplinën fiskale e financiare, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka miratuar një paketë aktesh nën-ligjore që forcojnë dhe harmonizojnë proceset e hartimit, zbatimit, raportimit, monitorimit e transparencës së buxheteve vendore.

Është kënaqësi për mua të ndaj me ju raportin e dytë zyrtar të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, tërësisht i dedikuar në analizën e tendencave dhe performancës së financave vendore. Raporti vjen si pjesë e përpjekjeve të Ministrisë për rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë mbi përdorimin e financave publike në nivel qendror dhe vendor. Ky raport, gjithashtu përmban informacion se nga vijonë të ardhurat dhe si i përdorin fondet njësitet e vetëqeverisjes vendore, i paraqitur në mënyrë të thjeshtëzuar për të ndihmuar të gjithë qytetarët dhe grupet e interesit të kuptojnë më shumë në lidhje me menaxhimin financiar në nivel vendor, e për t'iu lehtësuar kështu edhe pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrjen e autoriteteve vendore.

Raporti është hartuar nga Drejtoria e Financave Vendore e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me mbështetjen e Projektit të Qeverisë Zvicerane "Financat Lokale", duke sjellë kështu edhe një perspektivë të rëndësishme në menaxhimin financiar në nivel vendor.

MINISTËR

Anila Denaj

Ky raport është përgatitur me mbështetjen e projektit 'Financat Lokale' nga Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike SECO

FINANCATLOKALE | Forcimi i Menaxhimit
LOCALFINANCES | të Financave Publike
të Qeverisjes Vendore



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike, SECO

Përmbajtja

1.	Hyrje dhe metodologjia	11
2.	Ecuria e decentralizimit fiskal në Shqipëri dhe kuadri rregullator	14
3.	Niveli i implementimit të metodologjive të përcaktuara në ligjin për financat vendore nga NJVQV-të	17
3.1	Aktet nënligjore të hartuara dhe zbatimi në nivel vendor	17
4.	Analiza e treguesve të përgjithshëm të buxhetit vendor	20
4.1	Të ardhurat e shpenzimet vendore	20
4.2	Huamarrja vendore dhe detyrimet e prapambetura	39
5.	Analiza e risqeve të pushtetit vendor	42
6.	Krahasimi i treguesve fiskal me vendet e rajonit	45
7.	Analiza e buxheteve sipas njësive të vetëqeverisjes vendore	53
7.1	Analiza e buxheteve sipas bashkive në të ardhura dhe shpenzime	53
101	Bashkia Tiranë	54
102	Bashkia Berat	55
103	Bashkia Bulqizë	56
104	Bashkia Delvinë	57
105	Bashkia Devoll	58
106	Bashkia Dibër	59
107	Bashkia Durrës	60
108	Bashkia Shijak	61
109	Bashkia Elbasan	62
110	Bashkia Cërrik	63
111	Bashkia Fier	64
112	Bashkia Patos	65
113	Bashkia Roskovec	66
114	Bashkia Gramsh	67
115	Bashkia Gjirokastrë	68
116	Bashkia Libohovë	69
117	Bashkia Has	70
118	Bashkia Kavajë	71
119	Bashkia Rrogozhinë	72
120	Bashkia Kolonjë	73
122	Bashkia Korçë	74
123	Bashkia Krujë	75

124	Bashkia Kuçovë.....	76
125	Bashkia Kukës.....	77
126	Bashkia Kurbin.....	78
127	Bashkia Lezhë.....	79
128	Bashkia Librazhd.....	80
129	Bashkia Lushnjë.....	81
130	Bashkia Malësi e Madhe.....	82
131	Bashkia Mallakastër.....	83
132	Bashkia Mat.....	84
133	Bashkia Mirditë.....	85
134	Bashkia Peqin.....	86
135	Bashkia Përmet.....	87
136	Bashkia Pogradec.....	88
137	Bashkia Pukë.....	89
138	Bashkia Sarandë.....	90
139	Bashkia Skrapar.....	91
140	Bashkia Poliçan.....	92
141	Bashkia Shkodër.....	93
142	Bashkia Tepelenë.....	94
143	Bashkia Memaliaj.....	95
145	Bashkia Tropojë.....	96
146	Bashkia Vlorë.....	97
147	Bashkia Divjakë.....	98
152	Bashkia Belsh.....	99
153	Bashkia Prrenjas.....	100
154	Bashkia Këlcyrë.....	101
155	Bashkia Fushë-Arrëz.....	102
156	Bashkia Konispol.....	103
157	Bashkia Vau i Dejës.....	104
159	Bashkia Selenicë.....	105
160	Bashkia Himarë.....	106
165	Bashkia Vorë.....	107
166	Bashkia Kamëz.....	108
167	Bashkia Ura Vajgurore.....	109
168	Bashkia Maliq.....	110
326	Bashkia Finiq.....	111
452	Bashkia Dropull.....	112
499	Bashkia Pustec.....	113
654	Bashkia Klos.....	114

7.2	Analiza e buxheteve sipas Këshillave të Qarqeve në të ardhura dhe shpenzime.....	115
011	Këshilli i Qarkut Gjirokastrë.....	115
015	Këshilli i Qarkut Korçë.....	116
018	Këshilli i Qarkut Kukës.....	117
020	Këshilli i Qarkut Lezhë.....	118
033	Këshilli i Qarkut Shkodër.....	119
035	Këshilli i Qarkut Tiranë.....	120
037	Këshilli i Qarkut Vlorë.....	121
042	Këshilli i Qarkut Berat.....	122
046	Këshilli i Qarkut Dibër.....	123
047	Këshilli i Qarkut Durrës.....	124
048	Këshilli i Qarkut Elbasan.....	125
049	Këshilli i Qarkut Fier.....	126
8.	Objektivat e treguesve buxhetorë të pushtetit vendor për vitin 2020.....	127
9.	Përfundime dhe Rekomandime.....	128

Lista e grafikëve

Grafiku 1: Të ardhurat totale të pushtetit vendor, në përqindje ndaj PPB dhe të ardhurave publike 2010-2019.....	20
Grafiku 2: Të ardhurat e veta të NJVQV-ve dhe ritmi i rritjes së tyre.....	21
Grafiku 3 : Të ardhurat faktike të njësisve të vetëqeverisjes vendore sipas burimit 2010 - 2019.....	21
Grafiku 4 : Pesha në % e të ardhurave faktike të pushtetit vendor 2010-2019.....	22
Grafiku 5: Përbërja e të ardhurave të veta të NJVQV	23
Grafiku 6: Përbërja e të ardhurave të veta të NJVQV në përqindje.....	23
Grafiku 7: Rritja e të ardhurave të veta për 61 NJVQV 2019 vs 2018	25
Grafik 8 : Buxheti vendor 2018-2019.....	26
Grafiku 9: Shpenzimet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe ritmi i ndryshimit të tyre.....	26
Grafiku 10: Shpenzimet vendore krahasuar me shpenzimet publike (në miliardë lekë) dhe në përqindje të PBB-së.....	27
Grafiku 11. Shpenzimet e qeverisjes vendore 2019 sipas funksioneve (milionë lekë)	27
Grafiku 12: Shpërndarja e shpenzimeve sipas funksioneve në 2019 (përqindja ndaj totalit).....	28
Grafiku 13: Shpërndarja e shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik në 2019	28
Grafiku 14: Struktura e shpenzimeve vendore sipas klasifikimit ekonomik 2017-2019.....	29
Grafiku 15: Totali i shpenzimeve për banor për 2019 (mijë lekë).....	30
Grafiku 16: Shpërndarja e shpenzimeve sipas funksioneve për secilën bashki.....	31
Grafiku 17 : Shpenzimet për banor në katër funksionet kryesore.....	32
Grafiku 18: Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik për secilën bashki.....	33

Grafiku 19: Shpenzimet e personelit për banor për 2019 (mijë lekë).....	34
Grafiku 20: Shpenzimet administrative për banor për 2019 (mijë lekë).....	35
Grafiku 21: Shpenzimet kapitale për banor për 2019 (mijë lekë).....	36
Grafiku 22: Shpenzimet kapitale për vitin 2019 përkundrejt totalit.....	37
Grafiku 23: Ndryshimi i shpenzimeve kapitale 2019/2018.....	38
Grafiku 24: Detyrimet e ndara sipas kategorive.....	39
Grafiku 25: Stoku i Detyrimeve të prapambetura në fund të vitit.....	40
Grafiku 26: Detyrimet e prapambetura për frymë.....	40
Grafiku 27: Të ardhurat vendore në Evropën Juglindore, 2018.....	45
Grafiku 28: Të ardhurat vendore në Europën Juglindore në raport me PBB-në, 2018.....	46
Grafiku 29: Të ardhurat vendore (euro) për banor në Evropën Juglindore, 2018.....	46
Grafiku 30: Struktura e të ardhurave vendore në Europën Juglindore, 2018.....	47
Grafiku 31: Të ardhurat e veta (euro) për banor në Evropën Juglindore, 2018.....	48
Grafiku 32: Shpenzimet Vendore në Europën Juglindore, 2018.....	48
Grafiku 33: Struktura e shpenzimeve vendore sipas funksioneve në Europën Juglindore, 2018.....	49
Grafiku 34: Struktura e shpenzimeve vendore sipas klasifikimit ekonomik në Evropën Juglindore, 2018.....	50
Grafiku 35: Shpenzimet kapitale vendore në Evropën Juglindore, 2018.....	50
Grafiku 36: Shpenzimet kapitale për banor në Evropën Juglindore, 2018.....	51

Lista e tabelave

Tabela 1. Ecuria e shpenzimeve të qeverisjes vendore në 2019 krahasuar me 2018 (milionë lekë).....	29
Tabela 2. Shpenzimet bashkiake për katër funksionet primare.....	32

Shkurtime

MFE – Ministria e Financave dhe Ekonomisë

PBB – Produkti i Brendshëm Bruto

NJVQV – Njësi të Vetëqeverisjes Vendore

MFP – Menaxhimi i Financave Publike

PBA – Programi Buxhetor Afatmesëm

GMS – Grupi për Menaxhimin Strategjik

EMP – Ekipi i Menaxhimit të Programit

GMR – Grupi i Menaxhimit të Riskut

INSTAT – Instituti i Statistikave

Abstrakt

Rritja e rolit të qeverisjes vendore në cilësinë e jetës së qytetarëve është tashmë një reformë e cila gjithmonë e më shumë po merr formë si në drejtim të kapacitetit fiskal ashtu dhe të cilësisë së funksioneve që ushtrojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore. Karta Evropiane për Autonominë Vendore dhe Strategjia Kombëtare e Decentralizimit ishte një hap shumë i madh në drejtim të konsolidimit fiskal të pushtetit vendor, por gjithashtu përgjegjësi e shtuar në drejtim të shërbimeve me efekt të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve. Pas miratimit të ligjit të parë rregullator për menaxhimin e financave të vetëqeverisjes vendore është nxitur gjithnjë dhe më shumë konsolidimi fiskal dhe implementimi i metodologjive që kanë synim menaxhimin sa më efektiv të fondeve publike. Roli i njësive të vetëqeverisjes vendore në proceset zhvillimore të vendit është thelbësor, si rrjedhim përfshirja integrale në shërbimet më të rëndësishme publike është thelbi i decentralizimit dhe mirëqeverisjes. Rritja e kapaciteteve fiskale me qëllim sigurimin e burimeve të nevojshme financiare për ushtrimin e funksioneve ligjore, është një objektivi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë duke synuar menaxhimin e financave publike vendore mbi bazë performance. Eksperienca e vendeve të zhvilluara tregon qartë se pa një decentralizim të thelluar fiskal dhe të funksioneve publike drejt qeverisjes vendore, do të jetë gjithnjë dhe më i vështirë menaxhimi i shërbimeve publike për shkak të rritjes së kërkesës së qytetarëve për tu ofruar shërbimet sa më pranë tyre. Në këtë drejtim, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) ka patur objektivi të vazhdueshëm përmirësimit e proceseve të menaxhimit financiar publik në nivel vendor dhe unifikimin e tyre në nivel kombëtar me qëllim për të ardhur në ndihmë realizimit të punëve publike. Këto procese kanë nisur si në drejtim të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) ashtu dhe monitorimit të zbatimit të buxhetit mbi bazë produktesh.

Realizimi në kohë dhe në respekt të angazhimeve ligjore e në ligjore për hartimin e monitorimin e planit të të ardhurave dhe shpenzimeve është një faktor shumë i rëndësishëm që siguron një rol thelbësor në nxitjen dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Roli i njësive të vetëqeverisjes vendore duke qënë shumë pranë qytetarëve, është mjaft i rëndësishëm në identifikimin e nevojave reale dhe ofrimin e shërbimeve të një cilësie të shtuar. Reforma administrativo-territoriale ka mundësuar ngritjen e kapaciteteve dhe potencialit menaxhues të njësive të vetëqeverisjes vendore, duke rritur në këtë mënyrë të ardhurat e veta dhe gjithashtu eficientë e ushtrimit të funksioneve me një kosto më të ulët. Në mbështetje të reformave të ndërrmarra dhe zbatimit të Strategjisë së Decentralizimit, analizat mbi ecurinë vjetore financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore janë një informacion thelbësor jo vetëm mbi ndryshimet fiskale që po pëson qeverisja vendore, por gjithashtu edhe mbi ecurinë e konsolidimit të menaxhimit financiar publik në nivel vendor.

Ndarja e re administrativo-territoriale ndryshoi jo vetëm mënyrën e organizimit, por gjithashtu i dha qeverisjes vendore një frymëmarrje të re në menaxhimin e financave të tyre për të siguruar burime të shtuara për financimin e shërbimeve publike. Duke ju referuar periudhave pas tranzicionit, ndër vite qeverisja vendore ka patur problematika në kapacitetin fiskal dhe këtë e tregojnë të ardhurat nga burimet e veta vendore mjaft të ulëta në raport me PBB. Por nga ana tjetër, një pikë e dobët ka qënë mungesa e një kuadri rregullator për menaxhimin e financave publike në nivel vendor duke sjellë në këtë mënyrë vështirësi financiare për njësitë

e vetëqeverisjes vendore dhe shërbime të një cilësie të ulët. Një menaxhim i drejtë i financave vendore ndikon në cilësinë e shërbimeve që përfitojnë qytetarët dhe bizneset, duke rritur transparencën dhe përgjegjshmërinë në përdorimin e parave publike. Për rrjedhojë, fokusimi drejt menaxhimit financiar vendor mbështetur mbi produktet e prodhura nga përdorimi i parave publike është një objektiv i rëndësishëm për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Treguesit fiskal të pushtetit vendor pas reformës pësuan një kthesë shumë të rëndësishme e cila u shoqërua jo vetëm më rritje të burimit të të ardhurave, por gjithashtu dhe të shpenzimeve për shkak të kalimit të kompetencave të reja nga niveli qendror. Ky trend gjithnjë dhe më shumë nga viti në vit ka ardhur në konsolidim, duke theksuar kështu rolin e qeverisjes vendore në politikat ekonomike që ndikojnë jetën e qytetarëve. Në vijim, është e rëndësishme të mbështetet financimi i mëtejshëm i shërbimeve të qeverisjes vendore, si nëpërmjet fuqizimit të instrumentave për mirëmenaxhimin e financave publike vendore, ashtu edhe përmes thellimit të decentralizimit fiskal duke zgjeruar kapacitetin për gjenerimin e të ardhurave vendore. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përmes këtij Raporti Vjetor të Zbatimit të Buxhetit Vendor 2019 synon jo vetëm analizën e treguesve buxhetorë të vitit 2019 për gjithë pushtetin vendor apo sipas NJVQV-ve, por edhe identifikimin e punës së realizuar deri tani dhe proceseve që janë në vazhdim, në drejtim të arritjes së objektivave për menaxhimin efektiv të financave publike në nivel vendor.

1. Hyrje dhe metodologjia

Menaxhimi i Financave Publike (MFP) në nivel vendor është një proces i iniciuar prej shumë vitesh, por pas reformës administrativo-territoriale ajo mori një dimension të ri zhvillimi. Fragmentimi i pushtetit vendor ka bërë që në një pjesë të konsiderueshme të njësive të qeverisjes vendore (sidomos në ish komunitat) niveli i menaxhimit të financave publike të ishte shumë i ulët. Gjatë viteve nga raporte të ndryshme të organizmave kombëtare por dhe ndërkombëtar janë evidentuar dobësi të theksuara në mbledhjen dhe administrimin e të ardhurave, në kryerjen me efikasitet të shpenzimeve, në mbajtjen e kontabilitetit publik duke u reflektuar në këtë mënyrë në shërbime publike gjithnjë dhe më pak efikente. Në këtë drejtim menaxhimi financiar publik në nivel vendor ndër vite ka luajtur një rol të vogël në menaxhimin e punëve publike dhe rritjen e vlerës së shërbimit ndaj qytetarëve.

Pas zbatimit në një masë të madhe të planit të veprimit të përcaktuar në Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020, në vitin 2019 u synua konsolidimi fiskal i 61 njësive të vetëqeverisjes vendore dhe implementimi i plotë i metodologjive të përcaktuara në aktet nënligjore të ligjit për financat e vetëqeverisjes vendore. Transferimi i funksioneve të miratuara në dhjetor të vitit 2015 përmes ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”, nga qeverisja qendore tek ajo vendore ishte një sfidë e madhe në drejtim të transferimit të tyre së bashku me fondet e nevojshme financiare të cilat ishin në formën e transfertës specifike. Reforma e nisur në vitin 2016 imponoi ndryshime të rëndësishme edhe në aspektin financiar të qeverisjes vendore duke bërë që tashmë njësitë e reja vendore me shtrirjen e gjerë administrative të kenë edhe burime të shtuara financiare për t’u përdorur, tregues ky i cili vihet re qartë në të dhënat fiskale të vitit 2019. Një pikë e rëndësishme kthese për menaxhimin financiar publik në nivel vendor padyshim ishte miratimi i Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i cili siguroi mbështetjen financiare e fiskale si dhe parimet që do t’i sigurojnë vazhdimësinë e nevojshme reformave të decentralizimit të ndërmarra deri më tani nga Qeveria Shqiptare. Në vitin buxhetor 2019 objektivat e menaxhimit financiar në nivel vendor janë fokusuar si në thellimin e decentralizimit fiskal duke nxitur rritjen e të ardhurave nga burimet e veta të pushtetit vendor, ashtu edhe në menaxhimin e shpenzimeve publike vendore duke implementuar metodologjitë e reja të hartimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Viti 2019 mund të konsiderohet si viti i implementimit të të gjitha metodologjive të akteve nënligjore pasi u krijuan kushtet e favorshme ligjore dhe kapacitetet njerëzore që këto procese të monitorohen hollësisht nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes një drejtorie të dedikuar për menaxhimin financiar në nivel vendor. Në këto kushte, stafi i MFE ka punuar ngushtësisht përmes konsultimeve dhe trajnimeve me NJVQV-të, me qëllim jo vetëm implementimin e kuadrit nënligjor, por gjithashtu edhe të mbledhjes së informacionit mbi ecurinë e procesit e trajtimit të problematikave të shfaqura. Në këtë kuptim, disa prej arritjeve gjatë vitit buxhetor 2019 paraqiten si më poshtë:

- ❖ Implementimi i plotë i standardeve në procesin e hartimit të programit buxhetor afatmesëm dhe standartizimi i programeve buxhetore në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- ❖ Krjimi i një kalendari afatesh dhe rregullash nga të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore në formën e një udhëzimi të brendshëm për përgatitjen e buxhetit vendor;

- ❖ Rishikimi i udhëzimeve vjetore për përgatitjen e buxhetit vendor në përputhje me nevojat për informacion që kanë NJVQV-të në secilën fazë të përgatitjes së PBA-së dhe problematikave të paraqitura nga proceset e konsultimit;
- ❖ Miratimi i një kuadri metodologjik për identifikimin e rasteve të vështirësive financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore;
- ❖ Mbështetja e të gjitha NJVQV-ve me asistencë direkte nga personeli i MFE në procesin e implementimit të risive që solli Udhëzimi për Proçedurat Standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm.
- ❖ Zhvillimi i seancave periodike dëgjimore dhe konsultative midis qeverisë qendrore e asaj vendore;
- ❖ Zhvillimi i takimeve të vazhdueshme lidhur me procesin e hartimit të programit buxhetor afatmesëm nga stafi i MFE dhe projekti “Financat Lokale” i Ambasadës Zvicerane në asistencë të Drejtorisë së Financave Vendore.
- ❖ Implementimi i proçedurave të qarta të zbatimit të buxhetit vendor për të gjitha shpenzimet nga të ardhurat e veta vendore dhe gjithashtu për transfertat nga buxheti qendror;
- ❖ Monitorimi i zbatimit të buxhetit 2019 në përputhje me metodologjinë dhe proçedurat e miratuara në udhëzimin standard të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Zbatimi i këtyre masave në vitin buxhetor 2019 e në vazhdim, janë një siguri më shumë për rritjen e autonomisë financiare dhe për rrjedhojë më shumë fonde për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Një ndër objektivat e strategjisë së menaxhimit financiar vendor është të garantohet më shumë parashikueshmëri, stabilitet dhe transparencë e buxheteve vendore dhe njëkohësisht disiplinë financiare dhe mirëmenaxhim i financave publike në nivel vendor.

Përmes këtij Raporti Vjetor të Zbatimit të Buxhetit Vendor 2019 synohet të paraqitet një analizë e detajuar e tendencave dhe situatës financiare të vetëqeverisjes vendore por edhe në nivel njësie sipas 61 Bashkive dhe 12 Këshillave të Qarqeve. Kjo analizë ka për qëllim të evidentojë në mënyrë thelbësore burimet e financimit të bashkive, shpenzimet për ushtrimin e funksioneve dhe efektivitetin e përdorimit të burimeve financiare për vitin 2019, por edhe në raport me vitet e tjera krahasimore. Një hapësirë të rëndësishme zë analiza krahasimore me vendet e rajonit, niveli i implementimit të reformave në nivel vendor deri në vitin 2019 dhe objektivat që priten të zbatohen gjatë vitit 2020.

Kjo analizë është bazuar mbi të dhënat e mbledhura nga Drejtoria e Financave Vendore për 61 Bashki dhe 12 Këshilla Qarku në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (Sistemi i Thesarit SIFQ), informacioni zyrtar mbi buxhetet vendore i përcjellë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe nga INSTAT. Të dhënat janë të përpunuara nga grupi i punës në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nën asistencën e Projektit “Financat Lokale” të financuar nga Ambasada Zvicerane. Në funksion të analizave për numrin e popullsisë është përdorur treguesi sipas përcaktimeve të formulës së transfertës së pakushtëzuar në formën e banorëve rezidentë efektivë¹.

Gjithashtu, të dhënat krahasimore me vendet e rajonit janë marrë nga publikimet zyrtare të NALAS (Network of Associations of Local Authorities of South-East Europe) dhe për vendet e tjera të BE nga raportet e publikuara nga OECD-ja. Në analizën në tërësi të qeverisjes vendore, treguesit fiskal janë paraqitur në përputhje me metodologjinë kombëtarë të raportimit, duke mos përfshirë të dhënat nga transfertat e kushtëzuara që merr pushtetit vendor nga Ministrinë e Linjës. Ndërkohë në analizën krahasimore, treguesit për Shqipërinë respektojnë metodologjinë e NALAS në funksion të analizës me vendet e tjera të rajonit.

1. Banorë rezidentë efektivë = [CENSUS + (Regjistri i gjendjes civile – Census)*30%]

Për të ndihmuar në analizë, raporti ofron krahasime të të ardhurave dhe shpenzimeve në terma vjetor, dhe prezanton disa konkluzione mbi tendencat e financave vendore ndër vite krahasuar me vendet e rajonit. Gjithashtu pjesë e analizës janë arritjet e vitit 2019 në drejtim të menaxhimit financiar vendor dhe evidencime konkrete të zbatimit të buxhetit për secilën njësi të vetëqeverisjes vendore. Nga pikëpamja metodologjike, krahasimi me të dhënat faktike të viteve të mëparshme bëhet duke iu referuar 73 njësive të vetëqeverisjes vendore dhe mundëson nxjerrjen e disa konkluzioneve paraprake mbi përmirësimet e sjella nga reforma administrative territoriale në efikasitetin operacionale të njësive të vetëqeverisjes vendore ndër vite, por veçanërisht në vitin 2019.

Ky raport është vazhdimësi e një raporti vjetor të publikuar për herë të parë në vitin 2019 edhe të analizave integrale mbi ecurinë e financave publike pjesë e rëndësishme e të cilës janë dhe financat vendore.

2. Ecuria e decentralizimit fiskal në Shqipëri dhe kuadri rregullator

Decentralizimi është një nga elementet jetësore të menaxhimit të përgjegjësive publike. Struktura administrative në Shqipëri ka pësuar ndryshime rrënjësore që nga fundi i viteve 1990, vit ky i cili shënon nisjen e reformës së decentralizimit. Politika e decentralizimit nuk ka qënë gjithmonë e qëndrueshme dhe për rrjedhojë ka njohur ulje ngritjet e saj në vite. Hap i rëndësishëm ishte miratimi dhe zbatimi i Ligjit Nr. 8652, 31.07. 2000 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore”, që përcaktonte të drejtat dhe kompetencat e njësive të qeverisjes vendore në përputhje me Kushtetutën dhe Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Vendore, ligj i cili u shfuqizua në vitin 2015, pas miratimit të reformës administrative-territoriale (miratimi i ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

Vitet 2001 dhe 2002 mund të konsiderohen si më të suksesshmit në fushën e decentralizimit fiskal. Për herë të parë koncepti i transfertës së pakushtëzuar për pushtetin vendor u miratua në ligjin e buxhetit të shtetit të vitit 2001, duke rritur autonominë fiskale të njësive të vetëqeverisjes vendore për të mbledhur të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore si dhe përcaktimin e nivelit të tyre. Të ardhurat e gjeneruara në njësitë vendore janë përforcuar më tej përmes taksës vendore mbi biznesin e vogël, transferimin e të ardhurave nga taksat mbi regjistrimin e automjeteve taksës së pasurisë së paluajtshme etj. Reformë e rëndësishme u zhvillua për transferimin e pronave publike tek njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke ju dhënë e drejta e administrimit dhe zhvillimit të tyre. Që nga janari 2005 njësitë vendore janë përgjegjëse për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimet, si edhe për të gjitha çështjet financiare që shoqërojnë këto shërbime në buxhetin e njësisë vendore.

Në ligjin e buxhetit në vitin 2004 u përcaktua delegimi i arsimit parauniversitar tek njësitë vendore për sa i përket autoritetit dhe përgjegjësisë për mirëmbajtjen dhe funksionimin e mjediseve të arsimit parauniversitar që ndodhen në juridiksion e NJVQV-ve. Gjatë periudhës 2003-2005 janë ndërmarrë politika të rëndësishme dhe reformat legislative në fushën e arsimit parauniversitar, kujdesin parësor shëndetësor, ndihmën ekonomike dhe shërbimet sociale.

Vazhdimi i funksionimit të qeverisjes vendore me një numër të lartë të NJVQV deri në vitin 2014, ka rritur koston e përgjithshme administrative të kësaj qeverisjeje dhe menaxhimit të pushtetit vendor, si dhe e kanë bërë të vështirë ofrimin e shërbimeve me efikasitet dhe cilësi të lartë. Ashtu si në shumë vende të tjera evropiane Shqipëria ndërmori dhe zbatoi një reformë të konsolidimit administrativo-territoriale me miratimin e Ligjit 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, duke zgjidhur përfundimisht çështjet e fragmentarizimit të njësive vendore. Kjo reformë ishte në harmoni dhe komplementaritet me reformën e decentralizimit. Në këtë drejtim, një arritje e rëndësishme në drejtim të përmirësimit të procesit të decentralizimit në vendin tonë ishte miratimi i Strategjisë Kombëtare Ndërsektorale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020 (SKNDQV). Kjo strategji prezantoi një përfaqëse gjithëpërfshirëse ndaj decentralizimit dhe forcimit të qeverisjes vendore në përputhje me parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Vendore, si edhe me ato e Hapësirës Administrative Evropiane për qeverisjen vendore, me synim sigurimin e decentralizimit politik, administrativ dhe fiskal.

Rritja e autonomisë financiare të pushtetit vendor ka qënë një ndër sukseset e reformës së decentralizimit në vitet e para të decentralizimit. Deri në vitin 2009, në buxhetin vendor kanë dominuar transfertat e kushtëzuara dhe të pakushtëzuara ndërkohë që të ardhurat e veta kanë qënë në nivele të ulta. Në një farë mënyre konstatohet se qeveritë vendore për këtë periudhë kanë qënë të varuara nga transfertat ndërqeveritare. Ndërkohë në drejtim të shpenzimeve vendore vlen të përmendim se përbërja ekonomike e shpenzimeve vendore ka ndryshuar ndër vite, nga përqëndrimi vetëm tek shpenzimet për paga, tek një ndarje më e balancuar mes shpenzimeve për funksionimin dhe mirëmbajtjen dhe shpenzimeve kapitale.

Gjatë dekadës së fundit janë bërë shume ndërhyrje dhe ndryshime në ligjet për taksat dhe tarifatat vendore, të cilat kanë ndikuar në ndryshime të vazhdueshme të të ardhurave për njësitë e qeverisjes vendore dhe njëkohësisht kanë ndikuar në uljen e koeficientëve të parashikueshmërisë së buxheteve vendore. Gjithashtu, ndryshimet kanë patur efekte edhe sa i përket administrimit të taksave dhe tarifave vendore. Ndryshimet e shpeshta kanë rritur kostot e administrimit të taksave dhe tarifave vendore si dhe kanë ndikuar në stimulimin e evazionit fiskal vendor.

Njëri nga shembujt më tipik ka qënë ndryshimi i shpeshtë i cili ka ndodhur në bazën, nivelin dhe administrimin e taksës së biznesit të vogël në 10 vitet e fundit. Kjo taksë deri në vitin 2007 mbledhej nga administrata qendrore dhe të ardhurat i shkonin pushtetit vendor. Nga viti 2007 deri në vitin 2014 kjo taksë është mbledhur dhe administruar nga njësitë e qeverisjes vendore dhe pas këtij viti përsëri u kthye të mbledhet nga administrata qendrore dhe të ardhurat i kalonin njësiteve të qeverisjes vendore. Në vitet 2009-2012 ishin në fuqi disa kufizime fiskale që kishin të bënin me tarifatat vendore të cilat kishin ulur ndjeshëm mundësinë e rritjes së të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore të tilla si ku përcaktohej se shuma e tarifave vendore të aplikueshme për tatimpaguesit e biznesit të vogël nuk duhet të kalojë 10 për qind të nivelit tregues të taksës, sipas tabelës së taksimit të subjekteve të biznesit të vogël. Heqja e këtyre kufizimeve në vitin 2013 krijoi kushte dhe mundësi që të rritej pesha dhe rëndësia e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore në buxhetin vendor. Në kontekstin e decentralizimit dhe forcimit të autonomisë financiare të pushtetit vendor, gjatë këtyre viteve janë transferuar në nivel vendor, taksa të rëndësishme të cilat ndikojnë në rritjen e të ardhurave vendore.

Me zbatimin e legjisllacionit të ri për financat e vetëqeverisjes vendore është rritur autonomia fiskale e njësiteve të vetëqeverisjes vendore, ku:

- Të ardhurat e bashkive nga transfertat e pakushtëzuar janë rritur nga 12.2 miliard lekë në vitin 2013 në 17.6 miliard në vitin 2019;
- Lidhja e transfertës së pakushtëzuar me 1% të PBB-së, garanton stabilitet, parashikueshmëri dhe rritje me rritjen e ekonomisë;
- Të ardhurat e bashkive nga taksat e ndara, gjithashtu janë rritur në vlerën rreth 600 milion lekë për vitin 2019;
- Gjithashtu, reforma në taksën mbi pasurinë e paluajtshme dhe ngritja e kadastrës fiskale do të rrisin më tej të ardhurat për buxhetet vendore.

Një ndër sfidat kryesore për qeverisjen vendore është të përmbushen pritshmëritë në rritje të qytetarëve për shërbime dhe qeverisje më të mirë. Decentralizimi dhe urbanizimi kanë rezultuar në një presion më të madh mbi njësitë e vetëqeverisjes vendore për të financuar shërbimet publike dhe lehtësuar zhvillimin ekonomik. Ndërkohë që funksionet dhe përgjegjësitë e njësiteve

të vetëqeverisjes vendore janë rritur gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, decentralizimi fiskal dhe transferimi i fondeve nuk kanë ecur me të njëjtin ritëm, duke rezultuar në mungesa financimesh. Në kushtet e “konkurrencës” për fonde buxhetore dhe të kapacitetit për gjenerimin e të ardhurave vendore, njësitë e vetëqeverisjes vendore vazhdojnë të kenë mungesa burimesh për investime.

Thellimi i decentralizimit fiskal, rritja e autonomisë financiare dhe konsolidimi i financave vendore do të vazhdojnë të jenë një ndër objektivat kryesore në vazhdim në drejtim të përdorimit me efektivitet të fondeve publike në nivel vendor dhe përmirësimit të standardeve të shërbimeve që i ofrohen komunitetit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

3. Niveli i implementimit të metodologjive të përcaktuara në ligjin për financat vendore nga NJVQV-të

Ndryshime të rëndësishme në procesin e menaxhimit financiar publik u shoqëruan me miratimin e një sërë aktesh nënligjore në formën e udhëzimeve standarde që rregullojnë proceset e menaxhimit të financave vendore. Ligji për financat e vetëqeverisjes vendore në të njëjtën frymë me parimet e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë ka orientuar menaxhimin financiar vendor në të njëjtën metodologji me atë që sot është implementuar në nivel qendror. Proçedurat, rregullat dhe proceset e implementuara deri tani në nivel qendror janë zhvilluar nën asistencën teknike të organizmave ndërkombëtare dhe gjithashtu në përputhje me standardet që sot kërkohen nga institucionet ndërkombëtare si Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, OECD etj. Unifikimi me proçedurat ndërkombëtare ka marrë një kohë të gjatë për administratën në nivel qendror dhe si rrjedhim ky do të jetë një proces i vazhdueshëm për disa vite edhe në nivel vendor. Nga vlerësimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë konstatohet që ky proces do të zgjasë më pak se në nivel qendror për 3 arsye thelbësore:

- a. Gatishmëria e njësisve të vetëqeverisjes vendore për të bashkëpunuar dhe kontribuar si aktorë aktiv në këtë proces gjithëpërfshirës;
- b. Në kushtet kur kjo metodologji synon identifikimin e parave publike që përkthehet në produkte buxhetore (shërbime publike), për njësitë e vetëqeverisjes vendore duke qënë më afër shërbimeve publike e kanë më të thjeshtë vlerësimin konkret të produkteve të prodhuara.
- c. Asistenca e drejtpërdrejtë që kanë dhënë në vite jo vetëm në nivel qendror por edhe atë vendor organizmat ndërkombëtarë si USAID, Banka Botërore, Bashkimi Evropian apo dhe aktualisht Ambasada Zvicerane në Shqipëri përmes projektit të financuar nga SECO “Financat Lokale” që do të jetë një ndihmë pranë bashkive për të implementuar objektivat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në menaxhimin financiar publik.

Unifikimi nën proçedura të njëjta, por të ndryshme në raport me ato që zbatoheshin më parë, është një sfidë e cila lidhet edhe me ndryshimin historik dhe kulturor të proçedurave që ndiqnin njësitë e vetëqeverisjes vendore në gjithë ciklin e menaxhimit të sistemit buxhetor. Përfshirja në të njëjtin standard me nivelin qendror të proçedurave që ndjekin NJVQV-të në programimin, zbatimin dhe monitorimin e buxhetit është një parakusht për unifikimin dhe shtrirjen e sistemit informatik financiar të qeverisë tek çdo njësi vendore. Si rrjedhim, objektivat strategjikë të menaxhimit financiar në nivel vendor janë realizuar në disa komponentë të rëndësishëm, por mbeten për t'u implementuar disa elementë të tjerë për ta konsideruar të përfunduar.

3.1 Aktet nënligjore të hartuara dhe zbatimi në nivel vendor

Një ndër aktet nënligjore më të rëndësishme për menaxhimin e sistemit buxhetor në nivel vendor është Udhëzimi Standard nr. 23, datë 30.07.2018 “Për Proçedurat Standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”, përmes së cilit sigurohet rregullimi metodologjik i të gjithë hapave dhe aktorëve që do të përfshihen në

hartimin e programit buxhetor afatmesëm në nivel vendor. Nën të njëjtën frymë që përcakton ligji për financat vendore dhe procedurat që ndiqen aktualisht në nivel qendror u krijuan hapat dhe rregullat bazë që duhet të ndiqen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore nga hartimi i kalendarit të buxhetit deri tek shpërndarja e shpenzimeve sipas produkteve, që është ende në hapat e para. Vlen të theksohet se një ndër elementët e rëndësishëm të unifikimit ishte lista e programeve buxhetore sipas të cilave të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të programonin shpenzimet buxhetore. Kjo listë ezauron funksionet e përcaktuara për njësitë e vetëqeverisjes vendore në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe gjithashtu unifikon ndarjen funksionale të shpenzimeve me atë që aktualisht përdor niveli qendror dhe Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë. Miratimi i udhëzimit në mesin e vitit 2018, bëri të mundur që viti i parë i plotë i përdorimit të programeve të reja të unifikuara të ishte viti 2019. Nga analiza e programeve buxhetore afatmesme dhe raporteve të monitorimit të buxhetit është për t’u vlerësuar përshtatja ndaj këtij sistemi nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Gjithsesi, duke konsideruar edhe diferencat buxhetore të konsiderueshme mes njësive, duhet konsoliduar me tej struktura e programeve buxhetore në funksion të menaxhimit sa më efektiv dhe eficient të shpenzimeve publike. Nga ana tjetër mbetet sfida që ashtu si kodifikimi përdoret plotësisht sipas udhëzimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore të përdorin edhe emrtimin e programeve në përputhje me kërkesat e tij. Gjatë kësaj periudhe është dhënë asistencë e drejtpërdrejtë përmes trajnimeve të të gjithë stafeve të buxhetit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe ky proces do të vazhdojë deri në implementimin e plotë të përcaktimeve specifike të udhëzimit. Gjithashtu, Ministria e Financave dhe Ekonomisë çdo vit ka nxjerrë udhëzimet vjetore të përgatitjes së buxhetit me qëllim për tu ardhur në ndihmë me treguesit fiksialë afatmesëm dhe specifikimet teknike të nevojshme të gjitha njësive të vetëqeverisjes vendore.

Një tjetër akt i cili do t’i japë një impakt mjaft të madh ciklit të menaxhimit buxhetor është Udhëzimit Standard Nr. 22, datë 30.07.2018 “Për Procedurat Standarde të Monitorimit të Buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, udhëzim ky i cili do të rregullojë monitorimin mbi bazë treguesish financiarë dhe performance të njësive të vetëqeverisjes vendore. Metodologjia e miratuar në këtë udhëzim përbën një risi në formën e monitorimit të buxhetit vendor, përfshirja e treguesve për matjen e performancës buxhetore dhe lidhja e tyre me shërbimet publike të realizuara janë disa nga elementët më të rëndësishëm që po ndjek ky proces aktualisht. Metodologjia për monitorimin e realizimit të buxhetit përfshin shumë formate të cilat kanë si qëllim paraqitjen e një informacioni shterues me tregues financiarë dhe performancës së shërbimeve. Procesi i implementimit të udhëzimit standard gjatë kësaj periudhe ka patur sfidat e veta të cilat nga shumica e njësive të vetëqeverisjes vendore janë tejkaluar, duke realizuar me sukses kërkesat e udhëzimit. Mbetet një punë e madhe në drejtim të implementimit të plotë, objektiv të cilin Ministria e Financave dhe Ekonomisë po e ndjek me vëmendje me qëllim sigurimin e kushteve të nevojshme për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore është ofruar një komunikim i vazhdueshëm më stafin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me qëllim trajtimin dhe tejkalimin e vështirësive të identifikuara gjatë këtij procesi.

Një ndër risitë e ligjit për financat e vetëqeverisjes vendore ishte trajtimi për rastet e vështirësive financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore. Në kuadër të detyrimeve që përcakton ligji për financat e vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me Bankën Botërore, gjatë vitit 2019 u hartua Udhëzimi Nr. 26 datë 27.09.2019 “Procedura për Menaxhimin e Vështirësive Financiare për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”. Në këtë udhëzim u detejuan procedurat e identifikimit, vlerësimit dhe trajtimit të katër rasteve të vështirësive financiare duke përfshirë këtu të gjithë aktorët e mundshëm në këtë proces. Pas miratimit të udhëzimit Ministria

e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me projektin “Financat Lokale” ka zhvilluar disa takime rajonale për t’u ardhur në ndihmë njësive të vetëqeverisjes vendore me plotësimin e kërkesave. Udhëzimi është në hapat e parë të zbatimit dhe gjatë kësaj periudhe është arritur mbledhja e informacionit të nevojshëm nga të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore për ti klasifikuar më pas në njërin nga rastet e vëshitrësive. Ky proces do të jetë i vazhdueshëm dhe sigurisht do të ndihmojë jo vetëm Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, por dhe vetë njësitë e vetëqeverisjes vendore në ndërgjegjësimin ndaj rëndësisë që ka shëndeti financiar i tyre për realizimin e punëve publike.

Duke u mbështetur në objektivat strategjike me bindje mund të themi se një ndër objektivat më të rëndësishëm për MFE është shtrirja e AFMIS (Albanian Financial Management Information System) në nivel vendor. Të gjitha procedurat dhe hapat e ndjekura deri tani janë realizuar në funksion të unifikimit të të gjithë njësive të qeverisjes së përgjithshme në një sistem të avancuar informatik që përfshinë të gjitha procedurat e menaxhimit financiar publik. Ky është një proces i cili sigurisht do të kërkojë kohë, mbështetje financiare dhe asistencë teknike për t’u zbatuar në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore. Sistemit të krijuar aktualisht në nivel qendror i është dhënë mundësia e një hapësire të dedikuar për nivelin vendor me qëllim që t’i shtohet moduli për NJVQV-të. Aktualisht po punohet në drejtim të ngritjes së kapaciteteve dhe krijimit të hapësirës së nevojshme mbi të cilën do të realizohet shtritja e AFMIS tek njësitë vendore, proces ky i cili në vlerësimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë do të kërkojë një periudhë afatmesme implementimi. Bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore vlerësohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë si një element thelbësor në ndërtimin e një suksesi të përbashkët në drejtim të modernizimit të menaxhimit financiar publik në nivel vendor.

4. Analiza e treguesve të përgjithshëm të buxhetit vendor


4.1 Të ardhurat e shpenzimet vendore

Njësitë e vetëqeverisjes vendore në përputhje me përcaktimet që jep ligji, kanë burim financimi të ardhurat e veta (taksa dhe tarifa) dhe transfertat e buxhetit qendror në formë të kushtëzuar e të pakushtëzuar. Rritja e kapacitetit fiskal të NJVQV-ve për të siguruar më shumë të ardhura nga burimet e veta dhe ulja e varësisë nga transfertat e buxhetit qendror është një sfidë e hapur për të cilën po punohet si në nivel qendror ashtu edhe nga vetë njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Ecuria e përgjithshme e të ardhurave të vetëqeverisjes vendore


Nga analiza e të ardhurave që sigurojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2019 duke përfshirë të ardhurat nga burimet e veta dhe transfertat e buxhetit qendror, u arrit të realizohen 56.2 miliard lekë ose me një rritje prej 13% krahasuar me vitin 2018. Në këtë vlerë përfshihen të gjitha të ardhurat që janë në kompetencë të plotë të përdorimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Duke parë treguesit analitik krahasimor në grafikun 1 më poshtë, të ardhurat totale të buxhetit vendor të vitit 2019 janë më të lartat në dekadën e fundit jo vetëm në vlerë absolute por edhe në terma relativë. Kështu për vitin 2019, këto të ardhura nga burimet e veta dhe transfertat e buxhetit qendror prej 56.2 miliard lekësh përbëjnë rreth 3,17% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) dhe në masën 13,8 % të të ardhurave publike, krahasuar respektivisht me 2,93 % dhe 10,48% për vitin 2018.

Grafiku 1: Të ardhurat totale të pushtetit vendor, në përqindje ndaj PBB dhe të ardhurave publike 2010-2019




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Po të vështroni grafikun e mëposhtëm ku tregohen të ardhurat e buxhetit vendor dhe ritmi i rritjes së tyre, rritja e të ardhurave, pas vitit 2015 ka qënë në ritme të larta. Të ardhurat në vitin 2019 janë rritur me rreth 3.8 mld lekë krahasuar me vitin 2018, ndërkohë që krahasuar me vitin 2015 janë rritur me 13.3 miliardë lekë.

Grafiku 2: Të ardhurat e veta të NJVQV-ve dhe ritmi i rritjes së tyre


Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Megjithëse nën ritmin e një rritje të qëndrueshme në të gjitha vitet pas Reformës Administrativo-Territoriale, nga pikëpamja e kategorive sipas burimit, rritja e të ardhurave vendore nuk ka qënë proporcionale. Ashtu, si tregohet dhe në Grafikon 3 dhe 4 më poshtë, për vitin 2019 në përbërjen e të ardhurave në buxhetin e njësisve të vetëqeverisjes vendore pamvarësisht rritjes së madhe të të ardhurave të veta akoma një peshë të madhe e mbajnë nga transfertat e buxhetit qendror. Përkatësisht këto transfertat nga buxheti qendror janë në masën 54.4 % (përfshirë taksat e ndara) krahasuar me 45.6 % që kanë të ardhurat e veta të NJVQV-ve. Në këtë drejtim, gjithnjë dhe më shumë në kuadër të proceseve të decentralizimit qeveria shqiptare ka vënë theksin në rëndësinë që ka rritja e të ardhurave nga burimet e veta vendore, në mënyrë që njësitë e vetëqeverisjes vendore të jenë autonome në kuptimin fiskal të administrimit të financave publike.

Grafiku 3 : Të ardhurat faktike të njësive të vetëqeverisjes vendore sipas burimit 2010 - 2019

Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Grafiku 4 : Pesha në % e të ardhurave faktike të pushtetit vendor 2010-2019




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Në strukturën e **ardhurave të veta vendore** peshën kryesore e zënë të ardhurat fiskale nga taksat e tarifat, ku ndër të gjitha burimet e veta **taksa mbi pasurinë e paluajtshme** përbën burimin të rëndësishëm. Siç evidentohet nga Grafiku 5 dhe 6 më poshtë, megjithëse për vitin 2019 për këtë taksë është arritur të mblidhet vlera më e lartë historike prej 5.3 miliard lekë, rritja e saj nuk është në nivelet e planit të parashikuar krahasuar me një vit më parë, vit kur filloi zbatimi i metodologjisë së re të taksimit mbi bazë vlere. Pritshmëritë e larta të NJVQV-ve për databazën qendrore/kadastrën fiskale, nuk justifikojnë përpjekjet e munguara të një pjese të NJVQV-ve për zgjerimin e bazës së taksueshme të tyre dhe përcaktimin e një agjenti fiskal që është provuar si një faktor i rëndësishëm në përmirësimin e performancës së mbledhjes së detyrimeve vendore nga rezidentet. Parë në kënvështrimin e kapacitetit fiskal, qartësisht Bashkia Tiranë evidentohet si NJVQV me e madhe dhe më e konsoliduar në aspektin e menaxhimit financave publike vendore, duke dominuar më me shumë se gjysmën e të ardhurave vendore në nivel kombëtar. Bashkia Durrës që e vjen e dyta pas Tiranës, pësoi goditjen më të fortë në territorin e saj nga tërmeti 26 Nentorit, faktor ky i rëndësishëm i cili ndikoj të ardhurat nga ky burim. Këto janë disa nga faktorët kryesorë që kanë ndikuar dhe në arritjen e një treguesi jo në përputhje me planin fillestar të për tu mbledhur nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Angazhimi maksimal për përmirësimin e performancës së taksës mbi pasurinë e paluajtshme, mbetet një nga sfidat më të mëdha në proces jo vetëm e pushtetit vendor por edhe qendror në periudhën afatshkurtër e afatmesme. Plotësimi i regjistrimit qendror të pasurive të paluajtshme / kadastrës fiskale pritet të zvogëlojë kostot e administrimit të kësaj takse, të ndihmojë në standartizimin e praktikave lokale, dhe mbi të gjitha do të luajë një rol të rëndësishëm në procesin e parashikimit të të ardhurave, si një nga elementet kyç të menaxhimit të financave publike në nivel vendor.


Për vitin 2019, **Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë** përbën një ndër burimet më të mëdha të të ardhurave të veta vendore, duke arritur shifrën rekord prej 8.4 miliard lekë ose 33% të totalit të të ardhurave vendore dhe 17 % më shumë se 2018. Miratimi i Planeve të Përgjithshme Vendore pas Reformës Administrative Territoriale, i ka dhënë një hov kërkesave për ndërtime të reja duke i dhënë edhe mundësi NJVQV-ve për të siguruar të ardhura të konsiderueshme. Por, megjithëse kjo taksë e destinuar kryesisht për investime ajo është një burim i rëndësishëm për ndërtimin e infrastrukturës publike në funksion të ndërtimeve të reja. E rëndësishme për tu theksuar është, që kjo taksë natyrshëm, i përket NJVQV me potencialin më të madh për zhvillim ekonomik e social, ku për vitin 2019 rreth 74 % e kësaj takse i përket Bashkisë Tiranë.

Grafiku 5: Përbërja e të ardhurave të veta të NJVQV



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Grafiku 6: Përbërja e të ardhurave të veta të NJVQV në përqindje



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Tarifat nga shërbimet publike, që përfshin kryesisht pastrimin dhe mbledhjen e mbetjeve urbane, për vitin 2019 megjithëse pa rritje krahasuar me vitin 2018, është në nivele të qëndrueshme ndër vite në të ardhurat e veta të bashkive. Përdorimi nga pjesa më e madhe e NJVQV-ve, i Ndërmarrjeve të Ujësjetës, si agjent fiskal për mbledhjen e tarifave të shërbimeve publike nga rezidentet tregon një praktikë të mire në administrimin e tarifave. Por gjithashtu konstatohet në shumë raste që me gjithë synimin dhe orientimin ligjor, tarifat e mbledhura nga shërbimet publike nuk mbulojnë kostot përkatëse në shumicën e NJVQV-ve. Bazuar në problematikat e ndeshura vitin e fundit, NJVQV-të janë para obligimit dhe sfidave për të përshtatur metodologji specifike për llogaritjen e kostos së shërbimeve dhe shpërndarjen sa më të drejtë të barrës së detyrimeve midis bizneseve dhe qytetarëve duke ruajtur e zhvilluar një proces transparent me këto komunitete.

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e Biznesit të Vogël, për shkak të politikave reformuese të Qeverisë në vite vazhdoi edhe për vitin 2019 të ketë një kontribut minimal në financat vendore, në masën prej 1%.


Të ardhurat nga taksa e tarifa të tjera dhe burime jotatimore, të cilat për qëllime analitike, janë grupuar së bashku, përfshijnë të ardhurat nga tarifa për zënien e hapësirës publike, tarifa parkingu, administrative, taksa tabele e të tjera jotatimore, etj. Ky grup për 2019 paraqitet në të njëjtat vlera si 2018, duke qënë një burim i qëndrueshëm prej 7.3 miliardë lekë.

Në vazhdim të analizës si më lart, është e rëndësishme për të vënë në dukje që në të ardhurat e veta të gjeneruara nga NJVQV-të në rang kombëtar, Bashkia Tiranë përfaqëson natyrshëm pjesën takuese më të madhe të të ardhurave vendore. Kështu, Bashkia Tiranë ka gjeneruar rreth 54,2 % të totalit të të ardhurave të veta vendore, 43 % të taksës së pasurisë së paluajtshme, 73% të taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe 45,3 % tarifave të shërbimeve publike. Gjithashtu, Bashkia Tiranë është dukshëm rreth 10 herë më lart në gjenerimin e të ardhurave të veta, krahasuar me Bashkinë Durrës që vjen e dyta.

Ndonëse ecuria e përgjithshme e të ardhurave të veta vendore për vitin 2019 ka qënë në një trend rritës pozitiv prej 6 % krahasuar me vitin 2018, evidentohet që jo të gjitha NJVQV-të kanë përformuar pozitivisht. Midis 61 NJVQV-ve ka dallime të dukshme në performancë ku 38 Bashki kanë realizuar një rritje nga 4% - Tepelena në 79 % - Patosi. Bashkitë Diber dhe Fushë-Arrëz janë në vlera të barabarta me vitin 2018. Ndërsa 21 Bashki të tjera janë në një trend negativ duke filluar nga Bashkia Kurbin me -4 % dhe përfunduar me Bashkinë Pustec që për vitin 2019 shkon në masën -60% krahasuar me vitin 2018.

Më poshtë në grafikun 7, paraqiten diferencat në performancën e të ardhurave të veta për 61 NJVQV-të në vitin 2019 krahasuar me vitin e mëparshëm.

Grafiku 7: Rritja e të ardhurave të veta për 61 NJVQV 2019 vs 2018




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Në seksione të veçanta më poshtë, në këtë raport, paraqiten analiza të detajuara të performancës së të ardhurave të veta, për çdo njëri nga 61 NJVQV-të.

Ecuria e përgjithshme e shpenzimeve të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për buxhetin e pushtetit vendor, për vitin 2019, në krahasim me ato të vitit 2018, paraqiten në grafikun e mëposhtëm:


Grafik 8 : Buxheti vendor 2018-2019



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Shpenzimet e Pushtetit Vendor përbëjnë një tregues të rëndësishëm fiskal, duke demonstruar në këtë mënyrë peshën që kanë shërbimet vendore në financat publike të qeverisjes së përgjithshme në Shqipëri. Ndër vite, shpenzimet e qeverisjes vendore kanë pësuar luhatje, siç duket qartë edhe nga grafiku i mëposhtëm shpenzimet e pushtetit vendor janë rritur nga vitit në vit. Gjatë periudhës 2010-2016, shpenzimet vendore janë rritur duke kulmuar me një rritje prej 28% në 2016 kundrejt vitit të mëparshëm, si rezultat i zbatimit të reformës administrative - territoriale dhe transferimit të 7 funksioneve të reja tek qeverisjes vendore. Në vijim, duke marrë në analizë treguesit e shpenzimeve të qeverisjes vendore sipas grafikut 9 krahasuar me një vit më parë evidentohet një rritje në masën 7% në 2017 e po të njëjtën rritje në vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2019 u pasua nga një rritje prej 13%.


Grafiku 9: Shpenzimet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe ritmi i ndryshimit të tyre



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Duke ju referuar grafikut 10, buxheti vendor për vitin 2019 u realizua në masën 56.2 miliardë lekë ose 3.27% të PBBsë. Krahasuar me vitin 2010 kemi një rritje të shpenzimeve vendore me 0.08% të PBBsë ose 25.5 miliardë më shumë. Krahasuar me 2016 si vit i parë i zbatimit të reformës administrativo - territoriale, kemi një rritje me 0.31% të shpenzimeve vendore në raport me PBBnë ose 12.7 miliardë më shumë. Pas vitit 2016, shpenzimet e qeverisjes vendore janë rritur në rreth 10% në raport me totalin e shpenzimeve publike, nga rreth 8% që ishte gjatë periudhës së mëparshme 2013-2016. Në vitin 2019, shpenzimet e qeverisjes vendore shënuan 10.82% të totalit të shpenzimeve publike një rritje me 0.4% nga viti i kaluar 2018. Buxheti vendor 2020 parashikon që shpenzimet e pushtetit vendor të arrijnë në 3.2% të PBB-së, një ulje kjo me 0.1% në krahasim me një vit më parë.


Grafiku 10: Shpenzimet vendore krahasuar me shpenzimet publike (në miliardë lekë) dhe në përqindje të PBB-së



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Parë në këndvështrimin e analizës sipas funksioneve, në përfundim të vitit të parë të zbatimit të udhëzimit standard që rregullon buxhetimin në bazë të programeve, shpërndarja e shpenzimeve sipas funksioneve paraqitet në grafikun 11. Nga këto të dhëna për vitin 2019 konstatohet që funksioni i Çështjeve Ekonomike financohet me 13.4 miliardë lekë, të ndjekur nga Shërbimet e Përgjithshme Publike, Strehimi e Komunitetit me rreth 12 miliardë secila dhe Arsimi me 11 miliardë lekë. Shëndetësia, në kushtet kur dhe funksionet e pushtetit vendor në këtë drejtim janë minimale financohet më pak me vetëm 26 milionë lekë.


Grafiku 11. Shpenzimet e qeverisjes vendore 2019 sipas funksioneve (milionë lekë)



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Parë në këndvështrimin e peshës që zënë funksionet në raport me totalin e shpenzimeve konstatohen katër funksione kryesore (grafiku 12): Çështjet Ekonomike, Shërbimet e Përgjithshme Publike, Strehimi e Komoditetet e Komunitetit si dhe Arsimi. Shpenzimet në funksionin e Çështjeve Ekonomike zënë rreth 24% të totalit të shpenzimeve, të ndjekur nga shpenzimet në funksionin Shërbimeve të Përgjithshme Publike me 21.44%, shpenzimet në funksionin e Strehimit dhe Komoditetet e Komunitetit me 21.43% si dhe shpenzimet në funksionin e Arsimit me 19.16%.


Grafiku 12: Shpërndarja e shpenzimeve sipas funksioneve në 2019 (përqindja ndaj totalit)



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Ndërkohë, përsa i përket strukturës së shpenzimeve të pushtetit vendor sipas klasifikimit ekonomik (grafiku 13), pesha që zënë shpenzimet e personelit ndaj shpenzimeve totale për vitin 2019 është rreth 33.37, shpenzimet operative zënë rreth 26.62% ndaj totalit të shpenzimeve dhe shpenzimet për investime 31.81%. Vihet re pesha gjithmonë e në rritje e shpenzimeve për investime nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.


Grafiku 13: Shpërndarja e shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik në 2019



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Në krahasim me dy vitet e mëparshme, vihet re një ndryshim që ndodh për herë të parë në vitin 2019 (grafiku 14). Nëse shpenzimet e tjera korrente mbeten në një nivel të përafërt me 29.4 % përkundrejt totalit të shpenzimeve në 2019 nga 29.6% që ato ishin në vitin 2018, shpenzimet e personelit ulen në 38.8% në 2019 nga 41.7% në 2018 dhe shpenzimet kapitale përkundrejt totalit të shpenzimeve rriten në 31.8% në 2019 nga 28.7% në 2018. Kjo përbën një ndryshim të rëndësishëm në strukturën e shpenzimeve, pasi rritja e shpenzimeve kapitale ka një impakt në rritjen e cilësisë së shërbimeve vendore dhe rritjen ekonomike në njësinë vendore.

Grafiku 14: Struktura e shpenzimeve vendore sipas klasifikimit ekonomik 2017-2019



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Tabela nr 1 pasqyron ecurinë e shpenzimeve të qeverisjes vendore në zëra të vecantë sipas klasifikimit ekonomik në 2019 krahasuar me 2018 e 2017. Në vitin 2019 janë shpenzuar rreth 7 miliardë lekë më shumë në krahasim me vitin 2018, ku rriten prej 3.7 miliardë lekë e përbëjnë shpenzimet për investime.


Tabela 1. Ecuria e shpenzimeve të qeverisjes vendore në 2019 krahasuar me 2018 (milionë lekë)

	2019	2018	2017	2019 / 2018
Shpenzime nga Qeverisja Vendore	56,227	49,606	46,456	6,621
Shpenzime Korrente	38,340	35,383	30,191	2,957
Personeli	21,835	20,689	19,114	1,146
Shpenzime Operative Mirëmbajtje	14,966	13,475	10,127	1,491
Subvencione	180	127	138	53
Të tjera	1,359	1,092	812	267
Shpenzime Kapitale	17,887	14,223	16,265	3,664

Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Në vijim me interes paraqitet një analizë krahasimore e shpenzimeve sipas klasifikimit funksional dhe ekonomik ndërmjet bashkive. Grafiku 15 i mëposhtëm paraqet diferencat që vihen re në performancën e shpenzimeve për banor mes njësive të ndryshme të vetëqeverisjes vendore.

Grafiku 15: Totali i shpenzimeve për banor për 2019 (mijë lekë)




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Nga të dhënat grafike vihet re që Bashkia Tiranë ka nivelin më të lartë të shpenzimeve për banor, 30 mijë lekë për banor, ndjekur nga Bashkia Himarë 25 mijë lekë, Bashkia Mallakastër 22 mijë lekë. Ndërkohë nga ana tjetër, Bashkia Kurbin ka nivelin më të ulët të shpenzimeve për banor ose 8 mijë lekë. Mesatarja e shpenzimeve totale për banorë në 2019 është 15 mijë lekë.

Grafiku 16 pasqyron shpërndarjen e shpenzimeve sipas funksioneve për secilën bashki. Vihet re një ndryshim i konsiderueshëm i shpenzimeve për funksion ndërmjet bashkive. Funksioni në të cilën shpenzohet më shumë është Shërbimet e Përgjithshme Publike, ku Bashkia Përrenjas, Finiq, Pustec e Memaliaj shpenzojnë mbi 60% të shpenzimeve të tyre totale. Funksioni në të cilin shpenzohet më pak është Shëndetësia, ku vetëm Bashkia Dibër shpenzon 1.8% të shpenzimeve, Elbasan 0.16%, Berat 0.9%, Kruja 0.24% dhe Gramsh 0.2%.

Grafiku 16: Shpërndarja e shpenzimeve sipas funksioneve për secilën bashki



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Në Tabelën 2 pasqyrohet dinamika e shpenzimeve vendore sipas bashkive për secilën nga katër funksionet. Mesatarja e financimeve në katër funksionet është 85.9%, duke variuar nga 95.8% në Bashkinë e Himarës në 67.87% në Bashkinë e Shijakut. Evidencat e mëposhtme demonstrojnë rrethana të ndryshme ekonomike sociale në të cilat Bashkitë operojnë, duke reflektuar kështu edhe vendimmarrjen e tyre në shpërndarjen e shpenzimeve sipas funksioneve.


Tabela 2. Shpenzimet bashkiake për katër funksionet primare

	Mesatarja e shpenzimeve	Minimumi i Shpenzimeve	Maksimumi i Shpenzimeve
Çështjet Ekonomike	20.85%	2.02% (Himarë)	50.56% (Kamëz)
Shërbimet e Përgjithshme Publike	29.21%	6.98% (Kamëz)	65.37% (Përrenjas)
Strehimi dhe Komoditetet e Komunitetit	17.40%	0.00% (Pustec)	56.15% (Patos)
Arsimi	18.44%	2.52% (Finiq)	30.55% (Puka)
Total i katër funksioneve primare	85.90%	67.87% (Shijak)	96.23% (Delvina)

Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Grafiku 17 pasqyron shpenzimet për banor në katër funksionet kryesore. Mesatarja e shpenzimeve është 12, 988 mijë lekë, ku minimumi rregjistrohet në Bashkinë e Peqinit në masën prej 6,916 lekë dhe maksimumi është në Bashkinë e Tiranës në masën prej 27,547 lekë.


Grafiku 17 : Shpenzimet për banor në katër funksionet kryesore



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Përsa i përket shpërndarjes së shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik, sërish vihen re disa ndryshime mes bashkive (Grafiku 18). Dukshëm shpenzimet e personelit përbëjnë një komponent të rëndësishëm për shumicën e bashkive. Reduktimi i shpenzimeve të personelit, shoqërohet me rritjen e shpenzimeve kapitale.


Grafiku 18: Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik për secilën bashki



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Grafiku 19 pasqyron shpenzimet e personelit për banor për çdo bashki. Mesatarja e shpenzimeve të personelit për banor për 2019 është 7.6 mijë lekë dhe nga të dhënat konstatohet që në bashkitë me peshë të vogël në totalin e shpenzimeve vendore, pesha që zënë shpenzimet e personelit për banor është më e madhe. Bashkia Skrapar shënon nivelin më të lartë të shpenzimeve të personelit për banor prej 15 mijë lekë, ndjekur nga Fushë-Arrëz me 14 mijë lekë. Ndërkohë nivelin më të ulët të shpenzimeve e ka Bashkia Kamëz me 3.5 mijë lekë dhe Bashkia Shkodër me 4 mijë lekë.


Grafiku 19: Shpenzimet e personelit për banor për 2019 (mijë lekë)



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Nëse do të analizonim një mesatare të shpenzimeve administrative (shpenzimet e personelit dhe shpenzimet operative) për banor (grafiku 20), vihet re se Bashkia Skrapar ka nivelin më të lartë të shpenzimeve administrative për banor në 19 mijë lekë dhe ajo e Himarës në nivelin e 18 mijë lekë, bashkia Kamza ka nivelin më të ulët të shpenzimeve administrative prej 5 mijë lekë. Mesatarja e shpenzimeve administrative për banor është 11 mijë lekë.


Grafiku 20: Shpenzimet administrative për banor për 2019 (mijë lekë)



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Ndërkohë që nga ana tjetër grafiku 21 pasqyron shpenzimet kapitale për banor për çdo bashki. Parë në totalin e shpenzimeve, mesatarja e shpenzimeve kapitale për banor për vitin 2019 është 3.6 mijë lekë.

Grafiku 21: Shpenzimet kapitale për banor për 2019 (mijë lekë)




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Bashkia Tiranë shënon nivelin më të lartë të shpenzimeve kapitale për banorë në masën prej 12.6 mijë lekë, tre herë më shumë se mesatarja, ndjekur nga bashkia Mallakastra në masën prej 10 mijë lekë.

Në vitin 2019, mesatarja e shpenzimeve kapitale përkundrejt totalit të shpenzimeve është 31.8%. Por, vihen re bashki me shpenzime kapitale rreth 50- 60% të totalit të shpenzimeve, sikurse edhe bashki me shpenzime kapitale 0-5% të totalit të shpenzimeve (Grafiku 22).


Grafiku 22: Shpenzimet kapitale për vitin 2019 përkundrejt totalit



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Në krahasim me vitin 2018, në grafikun 23 pasqyrohet ndryshimi i shpenzimeve kapitale për çdo bashki mes 2019 dhe vitit të kaluar 2018.

Grafiku 23: Ndryshimi i shpenzimeve kapitale 2019/2018



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)


Ndër vite konstatohet që më shumë se gjysma e bashkive kanë përmirësuar treguesin e shpenzimeve kapitale. Rritja e shpenzimeve kapitale përkundrejt totalit të shpenzimeve të bashkisë varion nga 27.96% në Bashkinë e Vau të Dejës, në një rritje të vogël me 0.19% në Bashkinë e Kurbinit. Ndërkohë, Bashkia Libohovë ka një rënie të shpenzimeve kapitale me 38.21%, ndjekur nga Kolonja me 26.6%. Ndryshimet e raporteve në vite tregojnë trendin pozitiv të peshës që zënë investimet publike në buxhetet e njësisve të vetëqeverisjes vendore. Shumë bashki përballen me sfida të mëdha në drejtim të ruajtjes së kapacitetit fiskal dhe rritjes së cilësisë së punëve publike. Në këtë drejtim, gjithë dhe më shumë zbatimi i reformave në menaxhimin e financave publike janë premisë për një përmirësim të dukshëm të këtyre raporteve.

4.2 Huamarrja vendore dhe detyrimet e prapambetura

Në kuadër të evidentimit të detyrimeve të prapambetura të krijuara rishtazi, si dhe monitorimit të shlyerjes së tyre, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka vazhduar monitorimin e tyre edhe përgjatë vitit 2019. Për periudhën deri në dhjetor të vitit 2019, rezulton se stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të muajit dhjetor 2019, i cili parashikohet të shlyhet në një periudhë afatmesme është rreth 8.1 miliard lekë. Vlera neto e stokut të detyrimeve të prapambetura është rritur me rreth 1.9 miliard lekë, krahasuar me vlerën e detyrimeve të raportuar në tremujorin e tretë të vitit 2019, dhe është rritur me rreth 1.4 miliard lekë krahasuar me stokun e detyrimit në fund të vitit 2018.

Sipas kategorive, zëri “Investime” zë peshën më të madhe të stokut të detyrimeve me rreth 47%, “Mallra dhe Shërbime” me rreth 23%, “Vendime Gjyqësore” me rreth 13%, dhe “Të tjera” me rreth 11%. Pesa që zë stoku i detyrimit të mbetur në kategorinë “Vendime Gjyqësore” është ulur në 13%, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2019 që ishte 17%, ndërkohë që pesa që zë stoku i detyrimit të mbetur në kategoritë e tjera mbetet thajse në të njëjtat nivele.

Grafiku 24: Detyrimet e ndara sipas kategorive




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Sipas informacionit të njësisve të vetëqeverisjes vendore, stoku i detyrimit të mbetur është rritur ndjeshëm për arsye të cilat lidhen më së shumti me procedurat e likuidimit për mbylljen e vitit fiskal dhe gjithashtu një pjesë e detyrimeve janë krijuar si pasojë e fatkeqësisë natyrore të ndodhur gjatë tremujorit të katërt të vitit 2019. Detyrimet e krijuara rishtazi lidhen kryesisht me kategorinë “Investime”, “Mallra dhe Shërbime” dhe “Vendime Gjyqësore”. Në përbërjen e

detyrimeve për investime peshën më të madhe e zënë investimet për infrastrukturën vendore, dhe rikonstruksion ndërtesash. Megjithatë, një pjesë e detyrimeve të krijuara deri në dhjetor 2019 janë në proces likuidimi dhe ndërkohë pritet likuidimi i plotë i tyre në periudhën në vazhdim.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet ecuria e detyrimeve të prapambetura përgjatë periudhës 2015-2019. Sic vihet re ka patur një luhatje të tyre nga njëri vit në tjetrin. Në fund të vitit 2015, vlera e detyrimit ka qënë në shumën 11.8 mld lekë, shumë e cila ka ardhur duke u ulur si rezultat edhe i objektivave dhe prioriteteve që çdo njësi e vetëqeverisjes vendore ka vendosur në programin buxhetor afatmesëm për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Grafiku 25: Stoku i Detyrimeve të prapambetura në fund të vitit




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomise (2019)

Duke iu referuar detyrimeve në total, rezulton se bashkia e cila ka vlerën më të lartë të detyrimeve të lindura është bashkia Tiranë, me një vlerë prej 1.7 miliardë lekë në total, e ndjekur nga bashkia Kavajë me vlerë prej 766.2 milionë lekë, bashkia Kamëz me vlerë 408.3 milion lekëshkia Pogradec me vlerë 404.5 milion lekë, bashkia Lezhë me vlerë 360.5 milion lekë. Stoku i detyrimit të mbetur i bashkisë Tiranë zë peshën më të madhe ndaj totalit të detyrimit në masën 22%.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet detyrimi për frymë sipas bashkive. Vihet re se, bashkia Kavajë është bashkia me detyrimin më lartë për frymë, e ndjekur nga bashkia Konispol, Poliçan, Finiq, Rogozhinë, Libohovë.

Grafiku 26: Detyrimet e prapambetura për frymë



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomise (2019)

Huamarrja vendore

Në zbatim të Ligjit nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore në Shqipëri”, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë mundësi të marrin kredi nga sektori bankar dhe nga insitucionet e tjera financiare. Ky ligj i jep mundësinë njësive të vetëqeverisjes vendore të zgjerojnë autonominë financiare duke marrë hua afatgjatë dhe afatshkurtër me qëllim kryerjen e investimeve publike në territorin të cilin mbulojnë. Pas miratimit të ligjit dhe deri në ditët e sotme (një periudhë 12 vjecare), vihet re se vetëm 6 bashki kanë marrë hua nga bankat e nivelit të dytë, konkretisht bashkitë Tiranë, Elbasan, Korçë, Pogradec, Lezhë dhe Vlorë. Në tabelën e mëposhtme paraqitet një informacion mbi borxhin lokal, hua e marrë nga sektori bankar në vite.

Borxhi lokal										<i>mln/lekë</i>
Viti	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Shuma	147	218	285	387	863	957	901	827	716	582

Referuar edhe të dhënave të mësipërme vihet re një nivel i ulët i huamarrjes vendore. Njësitë e vetëqeverisjes vendore në kërkesën e tyre për të marrë hua, shpesh herë tejkalojnë aftësinë e tyre paguese, duke e planifikuar huanë e marrë për ta përdodur kryesisht për investime brenda mandatit zgjedhor (4-vjecar), ndërkohë që afati për të paguar kredinë shtrihet në kohë. Kjo do të sillte kufizime dhe vështirësi në planifikimin e investimeve për drejtuesit e bashkisë së re e cila me taksat e mbledhura nga qytetarët do të jetë e detyruar të shlyejë detyrimin e huasë së marrë. Theksojmë se është shumë e rëndësishme, që çdo njësi e vetëqeverisjes vendore duhet të përgatisë një analizë shumë të detajuar financiare në momentin që vendos të marrë një kredi. Konstatohet se, të ardhurat e veta të NJVQV nuk janë të mjaftueshme për të plotësuar të gjitha nevojat për shpenzime, duke penalizuar bashkitë në procesin e huamarrjes në bankat e nivelit të dytë, pasi nuk plotësojnë kriteret për shlyerjen e huasë. Ky mund të jetë edhe një kufizim i cili ka ndikuar edhe në numrin shumë të ulët të njësive vendore të cilat kanë zbatuar ligjin për huamarrjen vendore.

Në këtë këndvështrim, është shumë e rëndësishme që njësitë e reja vendore të krijuara pas reformës administrative-territoriale, duhet ti konsiderojnë fondet që do marrin hua si një vlerë e shtuar e cila do ti shërbejë komuniteti në një periudhë afatgjatë, nëpërmjet investimit të cilin do të mbulojnë me huanë e marrë.

5. Analiza e risqeve të pushtetit vendor

Rreziku fiskal mund të përkufizohet si “një burim i vështirësive financiare me të cilat mund të përballlet një bashki në të ardhmen”. Bashkitë nuk mund t'i shmangin plotësisht rreziqet fiskale, prandaj duhet të përpiqen të kontrollojnë dhe menaxhojnë ekspozimin e tyre ndaj rreziqeve në një mënyrë që maksimizon kthimin nga burimet e tyre. Nga eksperiencia e deritanishme, aftësia për ta bërë këtë ndryshon shumë nga një bashki në tjetrën, porë kjo në terma të menaxhimit financiar në nivel vendor. Në këtë këndvështrim duke marrë në shqyrtim praktikën më të mirë të menaxhimit të riskut financiar të institucioneve publike por edhe të situatës konkrete si ky proces është i organizuar në nivel vendor, kemi zhvilluar një analizë risku me qëllimin për të dhënë disa rekomandime të rëndësishme për tu mbajtur në konsideratë gjatë procesit të menaxhimit financiar në nivel vendor.

Rreziku fiskal i bashkive mund të vlerësohet sipas pesë kriterëve: situata ekonomike; situata socio-ekonomike; aftësia institucionale dhe gjendja e mjedisit.

Gjatë vitit 2019 njësitë e vetëqeverisjes vendore janë përballur me risqe të ndryshme, sa të ngjashme ndërmjet tyre aq edhe të ndryshme në varësi të karakteristikave të secilës njësi. Në këtë kuptim janë marrë në analizë disa nga rreziqet e identifikuara në nivel vendor, porë edhe në kuadrin e kriterëve të mësipërme.

Rreziqe të natyrës ekonomike. Në hartimin e një Plani të Përgjithshëm Vendor (PPV), bashkitë duhet të identifikojnë një numër objektivash zhvillimi të cilat janë potencial i rëndësishëm ekonomik. Në kuadrin e hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm, këto objektiva duhet të zërthehen në objektiva të politikës së programeve dhe produkte (që përfaqësojnë shërbimet që realizon bashkia konkretisht për qytetarët). Këto produkte duhet të kostohen për të vlerësuar koston e PPV-së dhe identifikimin me saktësi të alokimeve buxhetore për zbatimin sa më të suksesshëm të planit të përgjithshëm vendor. Produktet e specifikuar mund të paraqesin një rrezik të drejtpërdrejtë të qartë fiskal të bashkisë në pamundësi për të realizuar këto produkte, ndaj produktet e planifikuara duhet të jenë të realiste për tu realizuar dhe të mbuluara me burime e duhura ekonomike. Një pjesë e bashkive aktualisht kanë nisur procesin e buxhetimit mbi bazë produktesh, por pamvarësisht kësaj ky proces mbetet akoma në hapat e parë të tij. Realizimi i buxhetimit me produkte është forma më e avancuar e moderne e menaxhimit mbi bazë performante, si rrjedhim ajo do të kërkojë kohë dhe investime në burime njerëzore për tu bërë pjesë e natyrshme e buxhetimit tek njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Rreziqe të natyrës financiare. Vlerësimi financiar i një bashkie siguron një tregues të vështirësisë financiare që ka një bashki dhe për këtë arsye është një tregues i drejtpërdrejtë se sa afër është bashkia me një krizë financiare. Madhësia dhe qëndrueshmëria në realizimin e të ardhurave të veta vendore të parashikuara përbën një ndër parametrat më të rëndësishëm të gjendjes financiare. Devijimi mesatar i realizimit ndaj parashikimit të të ardhurave të veta për vitin 2019 ishte deri në 11% (por në bashki të veçanta kjo diferencë ndryshon në rritje ose në ulje). Ky ndryshim në riskun e qëndrueshmërisë financiare lidhet me:

- *Parashikimi i të ardhurave* shumë optimiste, sjell mungesë të kontrollit të angazhimeve nga ana e bashkisë si pasojë kontratave për shërbime publike vlera e të cilave tejkalon kapacitetin fiskal të njësisë për ti siguruar të ardhurat. Mosmbledhja në kohë e taksave

dhe tarifave vendore sjell një trend jo të zakonshëm të shlyerjes së shpenzimeve vendore nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

- *Taksa e pasurisë.* Shumica e Bashkive akoma kanë probleme serioze në përmirësimin e administrimit të Taksës mbi Pasurinë e Paluajtshme që është një nga burimet kryesore e të qëndrueshme të tyre financiare. Megjithë avantazhin që paraqet agjenti fiskal në mbledhjen e taksës së pasurisë së paluajtshme dhe detyrimeve të tjera vendore, pothuaj në shumicën e rasteve përcaktimi i tij është bërë në kushtet e mungesës së një alternative tjetër. Vetëm një numër i vogël i Bashkive kanë krijuar strukturat e dedikuara (njësi, sektor) për zgjerimin e bazës dhe administrimin e taksës së pasurisë.
- *Detyrimet e prapambetura* si përçindje e të ardhurave tregojnë se si një bashki është në gjendje të shlyejë apo të mbledhë detyrimet e prapambetura. Në këto kushte, njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të marrin masa për zvogëlimin e riskut nga që vjen nga krijimi i detyrimeve të prapambetura dhe shlyerja e atyre ekzistuese
- *Likuiditeti.* Asetet likuide neto si raport i shpenzimeve jep një tregues se sa mirë bashkia mund të trajtojë tronditjet ndaj kërkesave për shpenzime. Përlllogatija e një treguesi të tillë përbën një rëndësi të veçantë për shkak se ndihmon njësinë e vetëqeverisjes vendore në menaxhimin e pagesave.

Rreziqe të natyrës institucionale. Praktikrat e mira institucionale të një bashkie, funksionimi efektiv i Grupeve të Manaxhimit Strategjik (GMS), Ekipet e Manaxhimit të Programeve (EMP), Grupi i Manaxhimit të Riskut (GMR), njësitë e auditit të brendshëm etj, kanë një ndikim thelbësor në performancën e përgjithshme të një bashkie. Një kontribues kryesor për këtë është linja e përgjegjësisë dhe raportimit. Këto linja ndikojnë në autonominë dhe pavarësinë e vendimmarrësve dhe padyshim sjelljen e tyre të përditshme.

Përgjegjshmëria e (GMS) dhe anëtareve të Këshillit Bashkiak për të kuptuar rreziqet që lidhen me (mos) arritjen e objektivave.

- Funksionimi dhe vendimarrja e GMS, GMR, EMP është përgjithësisht e dobët dhe në disa raste jo në përputhje me kërkesat e legjislacionit për menaxhimin financiar publik, gjë që sjell mungesën e gjithpërfshirjes, vendimarrje ad hoc dhe të painformuara mirë. Menaxhimi i këtij risku është thelbësor për të krijuar një vendimarrje më transparente dhe të përgjegjshme.
- Kapacitete të limituara të implementimit të politikave të bashkisë. Perpjekja e Bashkive, që stafet vendore të përmiresojnë e forcojnë në mënyrë të vazhdueshme kapacitetet teknike të administrimit të tyre është një proces shumë i rëndësishëm. Mbajtja, motivimi dhe promovimi i zyrtarëve vendorë me eksperiencë dhe krijimi i kushteve optimale të punës, mbetet prioritet i rëndësishëm për menaxhimin e të ardhurave në nivel vendor dhe arritjen e objektivave të politikës.
- Kufizimi i përgjegjshmërisë menaxheriale të Kryetarëve të Bashkive gjatë zbatimit të buxhetit, nga ana e Këshillave Bashkiake, në disa raste ka sjellë mosmarrje të vendimeve operacionale në kohën e duhur dhe në përputhje me rëndësinë dhe urgjencën e problemeve të caktuara.

Rreziqe të natyrës socio-ekonomike. Bashkitë kanë një objektiv kushtetues për të siguruar zhvillimin social dhe ekonomik të territorit të cilin mbulojnë. Nëse kjo nuk realizohet, ekziston rreziku i pakënaqësisë së komunitetit që mund të shprehet përmes mospagimit të

taksave dhe migrimin larg bashkisë, gjë që çon në të ardhura më të ulëta që me kohë do të krijojë stres financiar. Një pengesë e treguesve socio-ekonomik është se për shkak të larmisë demografike në të gjithë vendin është e vështirë të zhvillohen tregues gjenerikë që mund të aplikohen në shkallë vendi.


Rreziqe të natyrës mjedisore. Eksperienca me tërmetet e fundvitit 2019 dëshmoi se treguesit e mjedisit duhet të konsiderohen në një vlerësim të rrezikut të ndikimit të një katastrofe mjedisore që mund të dëmtojë ndjeshëm burimet bashkiake dhe komunitare. Rasti i tërmetit do të kërkojë rindërtim jashtëzakonisht të kushtueshëm që do të ketë një barrë financiare për bashkitë që duhet të bartin, dhe për këtë arsye imponojnë një rrezik të nënkuptuar fiskal të mbështetjes së qeverisë lokale. Tërmeti i vitit të kaluar tregoi se të gjitha bashkitë e prekura ishin të papërgatitura në fondet dhe masat e emergjencës për t'ju dhënë përgjigje pasojave shkatërrimtare jo vetëm njerëzore, por edhe ekonomike që ai solli.

Rasti i COVID-19, është një tjetër shembull përsa më sipër. Në kushtet aktuale të situatës së pazakontë të pandemisë botërore, kur pjesa më e madhe e bizneseve dhe individët kanë marrë goditje të forta ekonomike, pritet që të ardhurat e veta të NJVQV-së të pësojnë një rënie të paparashikueshme, si rrjedhojë fokusimi në adresimin e problematikave të renditura më lart, do të mund të zbusë sado pak pasojat.

6. Krahasimi i treguseve fiskal me vendet e rajonit

Shqipëria, në krahasim me vendet e rajonit, sikurse edhe në vitet e mëparshme, edhe në vitin 2018 ka patur një sektor publik të vogël me të ardhura publike rreth 28% të PBB-së, ngjashmërisht me Kosovën, Maqedoninë e Veriut dhe Moldavinë, por më të ulët se mesatarja e vendeve të Ballkanit Perëndimor ashtu si mund të konstatohet në (Grafiku 26) (35.3%). Vendet si Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi apo Serbia kanë të ardhura publike mbi 40% të PBB-së dhe Kroacia rreth 47% të PBB-së, më të lartë se mesatarja e vendeve të OECD-së dhe të Bashkimit Evropian. Madhësia e sektorit publik jo domosdoshmërisht shoqërohet më madhësi më të madhe të qeverisjes vendore në këto vende, konstatim ky mbështetur mbi të dhënat e publikuara në raportet e OECD-së. Të ardhurat vendore të Kosovës në përqindje ndaj PBB-së, janë pothuajse të njëjta me të ardhurat vendore të Kroacisë. Ndërkohë të ardhurat vendore të Shqipërisë (3.8% të PBB-së) janë më të ulta se mesatarja e vendeve të Ballkanit Perëndimor (5.4%), se mesatarja e vendeve të Evropës Juglindore (5.9%) apo mes secilës nga vendet e Evropës Juglindore të marra në analizë.


Grafiku 27: Të ardhurat vendore në Evropën Juglindore, 2018



Burimi: OECD (2019), Tregues Kryesorë për Qeverisjen Vendore dhe Rajonale në BE; NALAS (2019), Treguesit e Decentralizimit Fiskal në Evropën Jug-Lindore, Edicioni I

Përsa i përket raportit të të ardhurave vendore përkundrejt të ardhurave të përgjithshme publike, Shqipëria në masën e 13.9% rënditet ngjashmërisht me Turqinë, Serbinë dhe Malin e Zi, më lart se Bosnja dhe Hercegovina, por nën mesataren e Ballkanit Perëndimor (15.9%), të Evropës Juglindore (16.9%) apo të Bashkimit Evropian (24.4%). Grafiku 28 pozicionon vendet e Evropës Juglindore në lidhje me të ardhurat vendore të gjeneruara si përqindje e të ardhurave publike dhe e PBB-së.


Grafiku 28: Të ardhurat vendore në Evropën Juglindore në raport me PBB-në, 2018



Burimi: OECD (2019), Tregues Kryesorë për Qeverisjen Vendore dhe Rajonale në BE, NALAS (2019), Treguesit e Decentralizimit Fiskal në Evropën Jug-Lindore, Edicioni I

Pas ndërmarrjes së reformës administrative-territoriale, Shqipëria duhet të intensifikojë hapat për rritjen e hapësirave fiskale në funksion të financimit të shërbimeve të vetëqeverisjes vendore ndaj komunitetit. Gjithashtu, Shqipëria duke ju referuar grafikut 29 të mëposhtëm zë një pozicion mjaft të ulët në raportin e të ardhurave vendore të mbledhura për banor në vetëm 171 Euro për banor.

Grafiku 29: Të ardhurat vendore (euro) për banor në Evropën Juglindore, 2018




Burimi: OECD (2019), Tregues Kryesorë për Qeverisjen Vendore dhe Rajonale në BE, NALAS (2019), Treguesit e Decentralizimit Fiskal në Evropën Jug-Lindore, Edicioni I

Grafiku 30 paraqet strukturën e të ardhurave vendore në vendet e Evropës Juglindore. Niveli i të ardhurave të veta për njësitë vendore në Shqipëri është në mesataren (39%), është mbi mesataren e Evropës Juglindore (35%), ngjashmërisht me Ballkanin Perëndimor (38%). Ky është një tregues i rëndësishëm i tendencës konsoliduese të autonomisë fiskale që njësitë

e vetëqeverisjes vendore në Shqipëri kanë patur pas reformës administrativo-territoriale. Gjithashtu, rritja e këtij raporti është një objektiv i vazhdueshëm me qëllim rritjen e kapacitetit fiskal të njëjsve të vetëqeverisjes vendore.

Grafiku 30: Struktura e të ardhurave vendore në Europën Juglindore, 2018




Burimi: OECD (2019), Key Data on Local and Regional Governments in EU; NALAS (2019), Treguesit e Decentralizimit Fiskal në Evropën Jug-Lindore, Edicioni i I

Duke marrë në analizë taksat e ndara konstatojmë që niveli i këtij burimi të të ardhurave është i ulët (2%) krahasuar me mesataren e Ballkanit Perëndimor (13%) apo të Evropës Juglindore (23%). Granti i Përgjithshëm apo transferta e pakushtëzuar në Shqipëri (27%) është më e lartë se mesatarja e Ballkanit Perëndimor (22%) apo e Evropës Juglindore (13%). Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova kanë nivele më të larta të transfertës së pakushtëzuar sesa Shqipëria. Të ardhurat nga grantet/ transfertat sektorale për Shqipërinë (12%) janë në nivelet më të ulta krahasuar me të gjitha vendet e Evropës Juglindore, nën mesataren e Ballkanit Perëndimor (19%) apo të Evropës Juglindore (20%) por një tregues ky që lidhet më shumë me numrin e funksioneve të transferuara në vendet e tjera të rajonit krahasuar me Shqipërinë. Ndërkohë, përsa i përket granteve për investime, Shqipëria (21%) përmes financimeve nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, renditet vetëm pas Bullgarisë (25%), mjaft më lart se mesatarja e Ballkanit Perëndimor (8%) apo e vendeve të Evropës Juglindore (9%). Ky instrument për rritjen e investimeve ka rezultuar efektiv në drejtim të zhvillimit rajonal dhe investimit në zona të cilat kanë patur nevojë për ndërhyrje të menjëhershme.

Referuar të dhënave të publikuara në raporte të ndryshme në grafiku 31 evidentohet që Shqipëria është ndër vendet me të ardhura të veta për banor më të ulta në rajon, 66 euro për banor, rreth dy herë më pak se mesatarja e Ballkanit Perëndimor (118 euro për banor). Qeverisja vendore në Shqipëri duhet të rrisë përpjekjet për një përmirësim të administrimit fiskal për mbledhjen e të ardhurave kryesisht nga taksa e pasurive të paluajtshme apo nga tarifat për shërbimet vendore. Kjo duhet shoqëruar edhe me një analizë të kujdesshme për një decentralizim të mëtejshëm fiskal në mbështetje të funksioneve të menaxhuara nga qeverisja vendore.


Grafiku 31: Të ardhurat e veta (euro) për banor në Evropën Juglindore, 2018



Burimi: NALAS (2019), Treguesit e Decentralizimit Fiskal në Evropën Jug-Lindore, Edicioni i I

Në grafikun 32 paraqitet mënyra si përdoren të ardhurat nga burimet e veta vendore në vendet e Evropës Juglindore. Shqipëria ka nivelin më të ulët të shpenzimeve vendore në rajon në masën 3.8% të PBB-së, ku mesatarja e shpenzimeve për Ballkanin Perëndimor është 5.3% apo mesatarja e rajonit të Evropës Juglindore është 5.9%. Gjithashtu, pjesa e shpenzimeve vendore përkundrejt shpenzimeve publike është në masën 13%, nën mesataren e Ballkanit Perëndimor (15%) apo të rajonit të Evropës Juglindore (16.8%), e ngjashme me Malin e Zi (12.9%), por pak më e lartë se Bosnja dhe Hercegovina (11.2%) dhe Sllovenia (12.2%). Prandaj një sfidë për procesin e konsolidimit fiskal të pushtetit vendor në Shqipëri është rritja e nivelit të shpenzimeve vendore në raport me produktin e brendshëm bruto por edhe me shpenzimet e përgjithshme publike.


Grafiku 32: Shpenzimet Vendore në Europën Juglindore, 2018



Burimi: OECD (2019), Tregues Kryesorë për Qeverisjen Vendore dhe Rajonale në BE; NALAS (2019), Treguesit e Decentralizimit Fiskal në Evropën Jug-Lindore, Edicioni i I

Gjithashtu duke ju referuar, grafikut 32 konstatohet niveli më i ulët për banor i shpenzimeve vendore në Shqipëri, ose rreth 169 euro për banor në Shqipëri, ku mesatarja e vendeve të Ballkanit Perëndimor është 279 euro për banor, apo mesatarja e rajonit të Evropës Juglindore 466 euro për banor. Parë në këndvështrimin e shpenzimeve sipas funksioneve grafiku 33. tregon sa financohen funksionet e qeverisjes vendore në Evropën Juglindore. Mesatarisht, 28% shpenzohet në arsim; ndërsa Shqipëria shpenzon 19%, duke lënë pas Turqinë dhe Bosnjën. Shqipëria shpenzon më shumë në çështjet ekonomike (18%) sesa mesatarja e vendeve të Evropës Juglindore dhe ngjashmërisht në funksionin e shërbimeve të përgjithshme publike (20%). Për mbrojtjen sociale shpenzohet vetëm 3% krahasuar me 7% që është mesatarja e rajonit. Një pjesë e konsiderueshme (39%) shpenzohet në kategorinë e të tjerave krahasuar me mesataren e rajonit prej 26%, ku përfshihet financimi i funksionit të strehimit dhe komoditetet e komunitetit. Në kategorinë e të tjerave, Shqipëria renditet e treta pas Turqisë dhe Kroacisë.


Grafiku 33: Struktura e shpenzimeve vendore sipas funksioneve në Evropën Juglindore, 2018



Burimi: OECD (2019), Tregues Kryesorë për Qeverisjen Vendore dhe Rajonale në BE; NALAS (2019), Treguesit e Decentralizimit Fiskal në Evropën Jug-Lindore, Edicioni i I

Grafiku 34 i mëposhtëm tregon strukturën e shpenzimeve vendore sipas klasifikimit ekonomik për rajonin. Shqipëria renditet pas Turqisë dhe kryeson vendet e tjera përsa i përket pjesës më të madhe të shpenzimeve kapitale. Mesatarja e vendeve të Ballkanit Perëndimor është 25% dhe mesatarja e vendeve të Evropës Juglindore është 25.3%. Shpenzimet e personelit në masën 33.6% janë nënmesataren e Ballkanit Perëndimor (38.8%).


Grafiku 34: Struktura e shpenzimeve vendore sipas klasifikimit ekonomik në Evropën Juglindore, 2018



Burimi: OECD (2019), Tregues Kryesorë për Qeverisjen Vendore dhe Rajonale në BE; NALAS (2019), Treguesit e Decentralizimit Fiskal në Evropën Jug-Lindore, Edicioni I

Gjithashtu, grafiku 35 tregon shpenzimet kapitale në Evropën Juglindore përkundrejt totalit të shpenzimeve për investime publike. Në Shqipëri shpenzimet kapitale vendore janë 31.2% e shpenzimeve totale për investime, pak më lart se mesatarja e vendeve të Ballkanit Perëndimor (28.3%), por nën mesataren e vendeve të Evropës Juglindore (40.5%), duke lënë pas Kosovën (25.3%), Serbinë (22.4%) dhe Malin e Zi (16.8%). Ky tregues shumë i rëndësishëm vlen të theksohet për faktin që tashmë njësitë e vetëqeverisjes vendore në Shqipëri, gjithmonë dhe më shumë po rrisin cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve përmes investimeve.


Grafiku 35: Shpenzimet kapitale vendore në Evropën Juglindore, 2018



Burimi: OECD (2019), Key Data on Local and Regional Governments in EU; NALAS (2019), Treguesit e Decentralizimit Fiskal në Evropën Jug-Lindore, Edicioni I

Në grafikun 36 paraqiten shpenzimet kapitale për banorë dhe në raport me PBB-në. Shpenzimet kapitale për njësitë e vetëqeverisjes vendore në Shqipëri janë 67 euro për banor, pak mbi mesataren e vendeve të Ballkanit Perëndimor (63 euro për banor), e treta në rajon pas Kosovës (75 euro për banor) dhe Malit të Zi (86 euro për banor), dhe nën mesataren e vendeve të Evropës Juglindore (114 euro për banor). Rritja e investimeve publike nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për shërbime të cilat rrisin produktivitetin e përdorimit të parave publike janë një tregues i rëndësishëm i një administrimi të përgjegjshëm financiar.

Grafiku 36: Shpenzimet kapitale për banor në Evropën Juglindore, 2018



Burimi: NALAS (2019), Treguesit e Decentralizimit Fiskal në Evropën Jug-Lindore, Edicioni i I

7. Analiza e buxheteve sipas njësive të vetëqeverisjes vendore

7.1 Analiza e buxheteve sipas bashkive në të ardhura dhe shpenzime

101 Bashkia Tiranë

Gjatë vitit 2019, bashkia Tiranë ka realizuar 13,882,963 mijë lekë të ardhura, të cilat zënë 54.2% të të ardhurave të mbledhura nga bashkitë, duke e renditur bashkinë Tiranë në vendin e 1-rë, të renditjes së bashkive sipas realizimit të të ardhurave. Në realizimin e të ardhurave, 12,668,092 mijë lekë, ose 91.2% janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2018, të ardhurat e bashkisë Tiranë janë rritur me 6.1%. Taksat kryesore të cilat zënë peshën më të madhe në totalin e të ardhurave të veta janë: Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja e cila përbën 64% të totalit; taksa mbi ndërtesën e cila përbën 19% të totalit. Më konkretisht, të ardhurat e bashkisë Tiranë, për vitin 2019, paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

(në mijë lekë)


Lloji i Taksës	Të ardhurat 2018	Të ardhurat 2019
Taksa mbi ndërtesën	1,821,267	1,837,765
Taksa mbi tokën bujqësore	23,978	21,585
Taksa mbi truallin	55,203	56,373
Taksa mbi transaksionet e kryera me pasuritë e paluajtshme	326,037	326,454
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	5,463,890	6,228,385
Taksa e fjetjes në hotel	95,454	114,691
Taksa e tabelës	291,764	262,791
Taksa vendore të përkohshme	683,559	705,622
Taksa mbi biznesin e vogël	166,389	181,580
Taksa të tjera	616,673	758,129
Tarifa vendore për zënien e hapësirave publike	397,293	387,229
Tarifa e pastrimit dhe higjienës	1,963,845	1,787,488
Taksa vendore e gjelbërt	72	0
Të ardhura jo Tatimore	1,173,158	1,214,870
TOTALI	13,078,581	13,882,963

Në vitin 2019, bashkia Tiranë me një popullsi prej rreth 638,716 banorë ka realizuar 19,404,024 mijë lekë shpenzime. Në krahasim me vitin 2018 këto shpenzime janë rritur me rreth 3,374,323 mijë lekë, ku në vitin 2018 ato ishin rreth 16,029,701 mijë lekë. Në tabelën e mëposhtme, jepen shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në fakt:

(në mijë lekë)

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik			Diferencat vjetore 2019-2018	Raporti i ndryshimit
	2019	2018	2017		
Shpenzime Korrente	11,356,629	9,812,043	7,624,730	1,544,586	116%
Personeli	5,025,530	4,717,872	4,287,201	307,658	107%
Operative	5,777,730	4,791,755	3,093,174	985,975	121%
Të tjera	553,369	302,416	244,354	250,953	183%
Shpenzime Kapitale	8,047,395	6,217,658	4,062,843	1,829,737	129%
TOTALI	19,404,024	16,029,701	11,687,572	3,374,323	121%

Për vitin 2019, bashkia Tiranë ka kryer 30.4 mijë lekë shpenzime për banor, nga të cilat 7.9 mijë lekë shpenzime personeli për banor dhe 12.6 mijë lekë shpenzime për investime për banor. Peshat që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2019 është rreth 26%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 30% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 3%, ndërsa ato për investime rreth 41%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar, transfertën specifike dhe nga të ardhurat e veta. Raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2019 dhe 2018 jepet si më poshtë:



102 Bashkia Berat

Gjatë vitit 2019, bashkia Berat, ka realizuar 279,428 mijë lekë të ardhura, të cilat zënë vetëm 1.1% të të ardhurave të mbledhura nga bashkitë, duke e renditur bashkinë Berat në vendin e 15-të, të renditjes së bashkive sipas realizimit të të ardhurave. Në realizimin e të ardhurave, 237,487 mijë lekë, ose 85% janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2018, të ardhurat e bashkisë Berat janë ulur me 9.3%. Taksat kryesore të cilat zënë peshën më të madhe në totalin e të ardhurave të veta janë: taksa mbi ndërtesën e cila përbën 40% të totalit; taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja e cila përbën 27% të totalit. Më konkretisht, të ardhurat e bashkisë Berat, për vitin 2019, paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

(në mijë lekë)


Lloji i Taksës	Të ardhurat 2018	Të ardhurat 2019
Taksa mbi ndërtesën	44,360	45,874
Taksa mbi tokën bujqësore	15,619	11,820
Taksa mbi truallin	17	74
Taksa mbi transaksionet e kryera me pasuritë e paluajtshme	1,904	2,022
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	49,651	31,054
Taksa e fjetjes në hotel	4,691	5,083
Taksa e tabelës	3,374	2,035
Taksa vendore të përkohshme	0	0
Taksa mbi biznesin e vogël	2,303	3,801
Taksa të tjera	67,890	47,169
Tarifa vendore për zënie e hapësirave publike	13,247	12,796
Tarifa e pastrimit dhe higjienës	65,605	63,747
Taksa vendore e gjelbërt	12,738	12,011
Të ardhura jo Tatimore	26,794	41,942
TOTALI	308,193	279,428

Në vitin 2019 bashkia Berat me një popullsi prej 71,983 banorë ka realizuar 903,812 mijë lekë shpenzime. Në krahasim me vitin 2018 këto shpenzime janë rritur me rreth 34,695 mijë lekë, ku në vitin 2018 ato ishin rreth 869,117 mijë lekë. Në tabelën e mëposhtme, jepen shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në fakt:

(në mijë lekë)

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik			Diferencat vjetore 2019-2018	Raporti i ndryshimit
	2019	2018	2017		
Shpenzime Korrente	658,495	705,378	669,454	-46,883	93%
Personeli	479,791	467,723	434,643	12,069	103%
Operative	150,670	208,451	180,499	-57,781	72%
Subvencione	23,000	23,476	36,300	-476	98%
Të tjera	5,033	5,728	18,012	-695	88%
Shpenzime kapitale	245,317	163,739	201,868	81,578	150%
TOTALI	903,812	869,117	871,322	34,695	104%

Për vitin 2019, bashkia Berat ka kryer 12.6 mijë lekë shpenzime për banor, nga të cilat 6.7 mijë lekë shpenzime personeli për banor dhe 3.4 mijë lekë shpenzime për investime për banor. Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2019 është rreth 53%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 17% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzimet e tjera 3%, ndërsa ato për investime rreth 27%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar, transfertën specifike dhe nga të ardhurat e veta. Raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2019 dhe 2018 jepet si më poshtë:



103 Bashkia Bulqizë

Gjatë vitit 2019, bashkia Bulqizë, ka realizuar 50,559 mijë lekë të ardhura, të cilat zënë vetëm 0.2% të të ardhurave të mbledhura nga bashkitë, duke e renditur bashkinë Bulqizë në vendin e 44-t, të renditjes së bashkive sipas realizimit të të ardhurave. Në realizimin e të ardhurave, 46,659 mijë lekë, ose 92.3% janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2018, të ardhurat e bashkisë Bulqizë janë rritur me 17.1%. Taksat kryesore të cilat zënë peshën më të madhe në totalin e të ardhurave të veta janë: Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja e cila përbën 50% të totalit; taksa mbi biznesin e vogël e cila përbën 32% të totalit. Më konkretisht, të ardhurat e bashkisë Bulqizë, për vitin 2019, paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

(në mijë lekë)


Lloji i Taksës	Të ardhurat 2018	Të ardhurat 2019
Taksa mbi ndërtesën	1,476	1,619
Taksa mbi tokën bujqësore	11	2
Taksa mbi truallin	0	0
Taksa mbi transaksionet e kryera me pasuritë e paluajtshme	85	24
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	4,037	4,900
Taksa e fjetjes në hotel	0	0
Taksa e tabelës	230	114
Taksa vendore të përkohshme	0	0
Taksa mbi biznesin e vogël	1,024	3,129
Taksa të tjera	9,997	15,578
Tarifa vendore për zënien e hapësirave publike	0	0
Tarifa e pastrimit dhe higjienës	22,719	21,291
Taksa vendore e gjelbërt	0	0
Të ardhura jo Tatimore	3,577	3,900
TOTALI	43,158	50,559

Në vitin 2019, bashkia Bulqizë me një popullsi prej 33,974 banorë ka realizuar 575,940 mijë lekë shpenzime. Në krahasim me vitin 2018, këto shpenzime janë rritur me rreth 149,973 mijë lekë, ku në vitin 2018 ato ishin rreth 425,967 mijë lekë. Në tabelën e mëposhtme, jepen shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në fakt:

(në mijë lekë)

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik			Diferencat vjetore 2019-2018	Raporti i ndryshimit
	2019	2018	2017		
Shpenzime Korrente	354,351	330,480	287,553	23,870	107%
Personeli	221,298	213,088	195,774	8,210	104%
Operative	130,762	107,393	90,308	23,369	122%
Të tjera	2,291	10,000	1,471	-7,709	23%
Shpenzime kapitale	221,589	95,486	101,168	126,103	232%
TOTALI	575,940	425,967	388,721	149,973	135%

Për vitin 2019, Bashkia Bulqizë ka kryer 17 mijë lekë shpenzime për banor, nga të cilat 6.5 mijë lekë shpenzime personeli për banor si dhe 6.5 mijë lekë shpenzime për investime për banor. Peshat që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2019 është rreth 38%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 23% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzimet e tjera rreth 0.4%, ndërsa ato për investime rreth 38%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar, transfertën specifike dhe nga të ardhurat e veta. Raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2019 dhe 2018 jepet si më poshtë:



104 Bashkia Delvinë

Gjatë vitit 2019, bashkia Delvinë ka realizuar 28,934 mijë lekë të ardhura, të cilat zënë vetëm 0.1% të të ardhurave të mbledhura nga bashkitë, duke e renditur bashkinë Delvinë në vendin e 53-të, të renditjes së bashkive sipas realizimit të të ardhurave. Në realizimin e të ardhurave, 19,951 mijë lekë, ose 69% janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2018, të ardhurat e bashkisë Delvinë janë rritur me 11.7%. Taksat kryesore të cilat zënë peshën më të madhe në totalin e të ardhurave të veta janë: taksa mbi tokën bujqësore e cila përbën 46% të totalit; taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja e cila përbën 26% të totalit. Më konkretisht, të ardhurat e bashkisë Delvinë, për vitin 2019, paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

(në mijë lekë)


Lloji i Taksës	Të ardhurat 2018	Të ardhurat 2019
Taksa mbi ndërtesën	2,296	2,422
Taksa mbi tokën bujqësore	3,496	4,475
Taksa mbi truallin		
Taksa mbi transaksionet e kryera me pasuritë e paluajtshme	101	57
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	1,360	2,512
Taksa e fjetjes në hotel		
Taksa e tabelës	28	28
Taksa vendore të përkohshme	0	0
Taksa mbi biznesin e vogël	200	278
Taksa të tjera	11,209	9,706
Tarifa vendore për zënie e hapësirave publike	192	215
Tarifa e pastrimit dhe higjienës	35	259
Taksa vendore e gjelbërt		
Të ardhura jo Tatimore	6,991	8,983
TOTALI	25,907	28,934

Në vitin 2019, bashkia Delvinë me një popullësi prej 10,940 banorë ka realizuar në total 163,557 mijë lekë shpenzime. Në krahasim me vitin 2018, këto shpenzime janë ulur me rreth 16,212 mijë lekë, ku në vitin 2018 ato ishin rreth 179,768 mijë lekë. Në tabelën e mëposhtme, jepen shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në fakt:

(në mijë lekë)

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik			Diferencat vjetore 2019-2018	Raporti i ndryshimit
	2019	2018	2017		
